

Kumbona e së Diellës



Piktura origjinale e Zojës së Shkodrës 1467 - Genazzano, Itali

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.3/4, Mars - Prill 2017

ZBULOHEK “ZOJA E SHKODRËS”, DYFISH MË E MADHE NGA Ç'DIHEJ

Sivjet jemi në 550 vjetorin ku sipas gojëdhënës, figura e Zojës u shkëput nga muri i Shenjtërores rrëzë kështjellës së Rozafës dhe u ndal në Genazzano, afër Romës.

Më 25 prill 1467, figura e Zojës, atëherë afresk në një mur të Kishës rrëzë kalasë së Rozafës, u shkoq prej vendit dhe, e ndjekur prej dy katolikëve shkodranë, Gjergjit dhe Sclavit, më 25 prill 1467, zuri vend në Kishën e Genazzanos në Itali. Tashmë ky shtegtim i “Zojës së Këshillit të Mirë”, mbush plot 550 vjet dhe, me këtë rast, u mbajt më 22 prill të këtij viti në Shkodër një konferencë posaçme shkencore. Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e 13 studiuesve nga vendi dhe Italia.

Ekspertja Edlira Çausi e cila më një grup ekspertesh me 19-21 prill 2017 qëndroj në Gjenecano, thotë se surpriza e parë që ndeshi ishte fakti që përmasat reale të kësaj veprë janë sa dyfishi i asaj që jemi mësuar të shohim.

“Imazhi i Zojës është pikërisht imazhi i Shën Mërisë me Krishtin. E punuar me një teknikë të tipit “Grlikofiruse”, e realizuar në një suport muror, mbi një suva. Kjo pikturë e realizuar pjesërisht në teknikën e afreskut, por dhe me disa prekje në të thatë, është një bashkërendim teknikash. Ajo në krahasim më paraqitjen e mëparshme 42.5 me 31 cm., tani kuptohet se është bërë mbi një sipërfaqe murore prej 85 cm lartësi dhe 43 cm gjerësi. Dhe kjo ishte një surprizë e madhe që duhet të bëhet e ditur për të gjithë”..

Sipas saj, historia e “Zojës së Këshillit të Mirë”, apo, siç njihet më shpesh, e Zojës së Shkodrës, është vetë historia e katolicizmit ndër shqiptarë. Ky i fundit, me vdekjen e Gjergj Kastriot Skënderbeut, më 1468, nisi udhën e vet të kryqit.

Rreth vitit 1467, kur një ushtri e re e madhe e sulltanit u dynd mbi Shkodër, sipas gojëdhënës, figura e Zojës u shkëput nga muri i Shenjtërores rrëzë kështjellës së Rozafës. E mbartur nga engjëjt, mbështjellë prej një reje – vijon gojëdhëna- u ndal në Genazzano, afër Romës. Festa e 25 prillit e cila njihet edhe si dita e “Zojës së Këshillit të Mirë”, nga vendësit në Itali njihet si “La Vennuta” –“E ardhura”.

Por cilat janë teknikat e përdorura në punën e saj? Në bazë të hulumtimit shkencor të një ekipi specialistësh shqiptaro-italianë, të angazhuar nga Konferenca Ipeshkvnore Shqiptare “piktura murale është një pikturë në teknikën e afreskut, e prekur me teknikën e gjysmës së thatë. Kjo teknikë realizohet kur suvaja është ende e njomë dhe këto shenja janë të gjitha evidente, sidomos në aureolën e Shën Mërisë me Krishtin, dhe në disa elemente të tjera, siç është ajo e ylberit të sfondit apo e poltronës së Shën Mërisë me Krishtin. Ndërsa disa ngjyra, sipas analizave të bëra me rrezet “ultra violet”, që ne kemi bërë, gjatë hulumtimit në Genazzano, kanë rezultuar disa prekje në teknikat në të thatë. Sepse disa ngjyra të përdorura mbi këtë murale nuk janë kompatibël me teknikën e afreskut. Dhe janë shenja të përdorimit të një teknike mikse”.

Simon Shkreli





Papa Fraçesko KISHA - OAZ BUKURIE	4
Don Lush Gjergji PATER PIO	5
Dom Gjovalin Simoni PËRSHPIRTËRIA NDAJ ZOJËS	8
Don Anton Uka KOMUNIKIMI - NEVOJË E DOMOSDOSHME	11
Don Nosh Gjollaj TË MPOSHTEN KUNDËRSHTIMET	14
Redaksia FIGURA E ZOJËS - PASURI KOMBËTARE	17
Dom Nikë Ukgjini ZOJA NË PËRBALLJE HISTORIKE	19
Redaksia ZOJA RIKTHEHET NË KATEDRALE	23
Luigi Territo S.I. TË EDUKOHESH ME TË BUKURËN	24
Redaksia ZOJA E SHKODRËS - DRITA E SHQYPNIIS	27
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 3/4 (493-494) Mars - Prill 2017

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PAPA FRANÇESKO: KISHAT TË JENË OAZA BUKURIE PËR TË NDIHMUAR TAKIMIN ME ZOTIN

Bukuria e ndikimi i saj mbi shpirtin e njeriut, detyra e artistëve, rikualifikimi i periferive: këto ishin disa nga argumentet e fjalës së Papës Françesku për Akademitë Papnore, mbledhur në Takimin e tyre të 21-të, me temë “Shkëndija bukurie për një fytyrë njerëzore të qyteteve”. Fjala e Atit të Shenjtë u lexua nga Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin, para pjesëmarrësve të mbledhur në Pallatin e Kancelarisë në Romë, që të kujton arkitektin e famshëm italian Donato Bramante, i cili realizoi portikun e pallatit, konsideruar në historinë e artit si një nga më elegantët e ndërtuar ndonjëherë.

E pikërisht roli i artit dhe i së bukurës ishte në qendër të vëmendjes së fjalimit, drejtuar kreut të dikasterit vatikanas për Kulturën, kardinalit Gianfranco Ravasi, njëkohësisht, kryetar i Këshillit të Koordinimit ndërmjet Akademive Papnore. Papa përshëndet veçanërisht anëtarët e Institucionit më të lashtë akademik, Akademisë së shquar Papnore të Arteve të Bukura dhe të Letrave të Virtuozëve në Panteon, themeluar më 1542, e cila zgjodhi këtë vit temën e asamblesë. Kjo temë i sjell Atit të Shenjtë ndërmend dy gjëra.

Së pari, fjalën e Benediktit XVI drejtuar artistëve në nëntor 2009, ku thoshte: “Fatkeqësisht, çasti aktual karakterizohet, përveçse nga fenomene negative në nivelin shoqëror dhe ekonomik, edhe nga venitja e shpresës, nga një lloj mosbesimi në marrëdhëniet njerëzore, prandaj, shtohen shenjat e çkurajimit, të agresivitetit, të dëshpërimit... Çfarë mund të japë sërish entuziazëm e besim, çfarë mund ta inkurajojë shpirtin njerëzor të rigjejë udhën, të hedhë vështrimin drejt horizontit, të ëndërrojë një jetë të denjë për thirrjen e tij, nëse jo bukuria?”

Më pas, Papa Françesku tërheq vëmendjen drejt projekteve të rikualifikimit e të rilindjes së periferive e metropoleve, për të cilat po impenjohen arkitektë në zë. Propozojnë ato “shkëndija” bukurie, thekson Papa, që i bëjnë të shndrisin edhe periferitë më të humbura, duke u dhënë atyre së pari hijeshi njerëzore e pastaj urbane. E nuk harron edhe edukimin, Ati i Shenjtë, duke pasur parasysh thënien e shkrimtarit italian, Italo Calvino, sipas të cilit “qytetet, ashtu si ëndërrat, përbëhen nga dëshira e frika”.

Duke ftuar për një edukim estetik, që të mos i lërë hapësirë frikës, Papa vë në dukje se “kur nuk mësojmë të ndalemi, për të admiruar e për të vlerësuar të bukurën, nuk është çudi që çdo gjë të shndërrohet në objekt përdorimi e shpërdorimi të paskrupullt”.

Që këndeje, detyra për artistët, sidomos për ata që besojnë në Krishtin: “të krijohen vepra arti që, pikërisht përmes gjuhës së bukurisë, të bartin një shenjë, një shkëndijë shprese e besimi aty ku njerëzit duket sikur dorëzohen para indiferencës dhe shëmtimit. Arkitektë e piktorë, skulptorë dhe muzikantë, kineastë dhe shkrimtarë, fotografë dhe poetë, artistë të çdo disipline, janë të thirrur ta bëjnë bukurinë të shndrisë sidomos aty ku errësira e zymtësia e dominojnë jetën e përditshme... I ftoj të kujdesen për bukurinë e bukuria do të kujdeset për plagët e shumta, që rrjedhin gjak në zemrat e në shpirtin e burrave e grave të ditëve tona”.

Në takimin e sotëm u dha çmimi i Akademive Papnore, ex aequo, për dy persona: Chiara Bertoglio, për punën kërkimore në fushën e muzikologjisë e të letërsisë, si edhe për veprimtarinë e saj koncertiste, si edhe Claudio Cianfaglioni, për punën kërkimore poetike dhe për studimin e disa figurave të rëndësishme poetike të kohës sonë, ndër të cilët, atë David Maria Turollo, ndërsa i festohet 100-vjetori i lindjes.

Gjithashtu, morën Medaljen e Papisë, Michelle Vannelli, Maestro i Kapelës në Bazilikën e Shën Petronios në Bolonjë dhe Francesco Lorenzi, kompozitor e muzikant, themelues i grupit muzikor “The Sun” (Dielli).



Don Lush GJERGJI

Prishtinë

FRANÇESKO GRAZIO FORGIONE

- PATER PIO-
(1887 – 1968)

“Sëmundja dhe vuajtja janë dukuri të cilat, nëse më gjatë i hulumton dhe depërton, gjithnjë shtrojnë pyetje të cilat tejkalojnë mjekësinë dhe prekin thelbin e njeriut në këtë botë. Kështu që është lehtë të kuptojmë rëndësinë e detyrave në institucionet shoqërore-shëndetësore, ku është e pranishme jo vetëm përkujdesja shpirtërore, të cilët duhet të jenë të prirë me tërë vizionin human dhe me këtë të dinë plotësisht në mënyrë humane t'i ofrohen të sëmurit i cili vuan. Për të krishterin, shëlbimi i Krishtit dhe hiri i tij i shpëtimit, përfshinë tërë njeriun në gjendjen e tij njerëzore, pra, edhe atë të sëmundjes, vuajtjes dhe vdekjes.”

(Pjesa e fundit)

Zbutja e dhimbjeve

Në verë të vitit 1918, kthehet në San Giovanni Rotondo, ku do të vendoset përgjithmonë. Bashkësia e atjeshme e vogël jeton me modesti nga të ardhurat e arritura me punë të mundimshme në fushë. Me 20 shtator të këtij viti në trupin e atë Pio-s lajmërohen shenjat e mundimeve të Krishtit - stigmatë: vërtet pesë varret ishin paraqitur edhe më herët, vitin 1910 në Piani Romani, mirëpo atë Pio luti Zotin që t'ia fshehte këto shenja, sa treguese aq edhe të detyrueshme. Kështu vetë atë Pio kujton ngjarjen e jashtëzakonshme kur edhe definitivisht iu shfaqen stigmatë: *“Ishte kjo në mëngjes më 20 të muajit të kaluar (20 shtator 1918, vr. ime) në kor, pas meshës, kur papritmas më erdhi në sy sikur një gjumë i ëmbël [...] pashe një person të mistershëm [...] vëreja se duart, këmbët e kraharori më janë të shporuar dhe duke më rrjedhke shumë gjak nga to. Mendojeni dhimbjen që e përjetova atëherë e të cilën e kam pandërprerë gati për çdo ditë.”*

Nga ajo ditë, përditshmëria e atë Pio-s ka ndryshuar thellësisht. Tek besimtarët, stigmatë kanë shkaktuar një admirim të thellë, por edhe pak kureshtje; Kisha dhe shkenca janë të detyruara, ndonëse me supozime të ndryshme, të merren me këtë dukuri. Nami për atë Pio-n e as përshpirtëria e besimtarëve ndaj tij nuk ndryshuan natyrën e përvuajtjes të meshtarit të ri i cili vazhdonte kryerjen e detyrës së tij me energji të palodhshme dhe me përshpirtëri. Gjithë këto përvoja të rënda dhimbjeje dhe pjekurie shpirtërore e udhëheqin atë Pio-n në meditim të vazhdueshëm dhe të thellë mbi kuptimin e vuajtjes. Ai, i cili vuajti aq shumë që nga fëmijëria, si dhe gjatë tërë jetës, nga dita në ditë barti vuajtjet trupore, në veti ndjeu thirrjen e ngutshme që të ofronte ngushëllim dhe përkrahje atyre që vuanin.

Gjithnjë shtohet numri i besimtarëve, të sëmurëve, shtegtarëve që vinin në kuvendin San Giovanni Rotondo, që të mund të bisedojnë, të rrëfihen te ati Pio, apo thjeshtë të jenë pjesëmarrës në ndonjë shërbim të tij.

Puna e tij e “bariut të shpirtit” u bë gjithë e më e vështirë dhe besimtarët e shumtë e detyronin atë në ditë të rraskapitura me punë dhe fljime.

Nga spitali i vogël deri te ndërtimi i madh

Në janar të vitit 1925 pas peripecive të shumta dhe të panumërta, atë Pio kremtorisht përuroi spitalin e parë të vogël të quajtur „Shën Frani“, të cilin e kishte dashur me çdo kusht. Fjala është për një ndërtim të vogël me seli në kuvendin e vjetër të motrave klarise, në pjesën qendrore. Kishte mjete



të thjeshta por efektive (dy dhoma spitalore dhe një sallë për operime): udhëheqja iu besua punës vullnetare të disa besimtarëve, një grupi të vogël mjekësh dhe, natyrisht, vepronte në gjurmët e thella shpirtërore dhe organizative të atë Pio-s.

Fatkeqësisht, ky spital i vogël nuk veproi gjatë: qysh pas disa viteve u braktis, kurse gjatë tërmetit të vitit 1938 qe rrënuar deri në themele.

Në vitin 1940, tashmë atë Pio, ishte njeri i pjekur, së bashku me bashkëpunëtorët e tij rregulltarë dhe shekullarë themeloi këshillin për zbutjen e vuajtjeve të cilin ia parashtrori vetes si qëllim kryesor, si dhe për ndërtim të një spitali të madh. Dhe në ditët e vështira për gjithë italianët të goditur me të bëmat e tmerrshme të Luftës së Dytë Botërore, entuziazmin të cilin e solli ai në idealin e tij, karizma e tij e madhe si dhe dërgimi i tij i palodhshëm meshtarak, iu jepte frymëzim besimtarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij që me entuziazëm të përfshihen në këtë ndërmarrje.

Në vitin 1947 atë Pio dhe bashkëpunëtorët më të afërt të tij (të kujtojmë mes tjerëve, Carl Kisvaday, Giuglielmo Sanguinetti-in, Maria Savic, Angela Lupi, Idu Seitz dhe Barabara Ward) mund të fillojnë me ndërtimin e veprës së madhe të atë Pio-s: spitalin „Shtëpia për Zbutjen e Vuajtjes“.

Vendi në të cilin do të ndërtohet, u përzgjedh në maje të një kodre (të cilin banorët vendorë me respekt e quajtën “mal”) në shpatet e të cilit u ndërtua edhe kuvendi i kapucinëve.

Punëtorët në ndërtimin e atij spitali, iu dhanë punës së tyre me fuqi të jashtëzakonshme fizike dhe shpirtërore: në këto vite gjithçka frymonte me rrezatim gëzimi dhe besimi për të ardhmen dhe, gjithë kjo, duke iu falënderuar forcës dhe fuqisë si dhe motivimit të cilin atë Pio arrinte t'i frymëzonte banorët e atij vendi dhe më gjerë. Vepra u themelua si shoqëri aksionare (me kapital fillestar prej një milion lira) nga të cilat aksionarët kishin mohuar çdo lloj përfitimi, dhe u finansua gjithnjë duke iu falënderuar kontributeve të mijëra besimtarëve nga mbarë bota.

Mirëpo, me projektin e madh të spitalit, atë Pio nisi edhe iniciativa tjera të rëndësishme, të cilat kishin për qëllim rritjen shpirtërore, kulturore dhe morale. Kështu, themeloi redaksinë e vogël, e cila kujdesej për botimin e Fletushkës, pastaj Grupeve të Lutjes tashmë të njohura dhe të përhapura kudo në botë, duke u nisur prej qyteteve italiane, të ndihmuara me mbështetje të gjithanshme të papës Piut XII.

Më 26 korrik 1954, solemnisht u hap poliklinika, në të cilën, ndonëse ende nuk ishte e tëra e lëshuar për punë, mjekoheshin dhe shëroheshin shumë të sëmurë: ndihma e shpejtë, laborator për analiza, vizita e të sëmurëve nëpër shtëpia, otologjia, shërbimet stomatologjike, pediatria. Nga fotot e asaj kohe në fytyrat e njerëzve mund të lexohet entuziazmi dhe gëzimi që i kishte përfshirë zemrat e vendasve të San Giovanni Rotondo-s.

Më 5 maj 1956, solemnisht u hap i tërë spitali (Vepra), në prani të personaliteteve të ndryshme atë Pio mbajti fjalim me përmbajtje themelore dhe thelbore; “[...] *Kjo vepër të cilën po e shihni sot është në fillimin e saj, mirëpo që të ketë mundësi të rritet dhe të përqijet, këtë krijesë duhet ushqyer, kështu që kjo i rekomandohet edhe më tutje zemërgjerësisë suaj për të mos vdekur nga uria dhe kështu të bëhet kjo qendër qytet spitali i cili do jetë i përgatitur mirë teknikisht për ndërhyrjet më të guximshme klinike dhe njëkohësisht të jetë rregull asketik i betejave françeskane. Vend i lutjes dhe dijes, ku raca njerëzimi do të takojë përsëri Jezusin e Kryqëzuar si Bari të vetëm të një grigjeje të vetme”.*

Atë Pio, është plotësisht i vetëdijshëm se fillimi kremtor i kësaj Vepre, ishte vetëm hapi i parë i madh; rruga të cilën duhet kaluar, është ende e gjatë dhe me plot flajime dhe vetëmohime të përditshme. Bota e vuajtjes, së cilës atë Pio ia kushtoi pjesën e madhe të fuqisë së tij fizike dhe shpirtërore, është e komplikuar dhe me shumë ndryshime: ndërrohen nevojat e të sëmurëve, shkenca medicinale përparon vazhdimisht, kështu që iu imponon mjekëve nevojën e përhershme të përsosjes, kurse veprimtaria e rregulltarëve, ndihma e tyre shumë e vlefshme shpirtërore, gjithnjë ballafaqohet me sfida të reja.

Kështu që ai e mbyll fjalimin e tij të përrurimit me këto fjalë; “[...] *Një fazë e rrugës të cilën duhet kaluar ka përfunduar. Nuk guxojmë të ndalemi, por të përgatitur t'i përgjigjemi thirrjes dhe le të kryejë çdonjëri detyrat e tija: unë, me lutjet e mia, të një shërbëtori të parëndësishëm të Zotit tonë Jezu Krishtit, ju me dëshirat e juaja të zjarrta që në zemrat e juaja të përqafoni të gjithë njerëz të cilët vuajnë, kështu që së bashku me mua t'ia paraqesim të gjithat mëshirës së Atit Qiellor; ju përmes veprimtarisë së hirit shenjtërues, me bujari, qëndrueshmëri në të mirë, me qëllim korrekt. Përpara me përvujtëri të shpirtit dhe zemrës të ngritura lartë. Hyji le t'i bekojë të gjithë*

ata që punuan, punojnë dhe do të punojnë për këtë Shtëpi dhe të gjithë ju dhe familjarët tuaj ju shpërbleftë shumëfish, kurse në jetën tjetër të gjithëve ju dhuroftë amshimin e lumtur.

Dëshirojmë që Virgjëra tejet e Shenjtë e Hirit, si dhe ati serafik Shën Frani nga qielli, dhe Vikari i Krishtit, Kryemeshtari në tokë, ndërmjetësofshin që të plotësohen njetet tona.“

Vetëm një vit pas hapjes solemne atë Pio i ofron Veprën e tij Selisë së Shenjtë duke lajmëruar



projektin e zgjerimit të tij i cili fillon më 5 maj 1958. Në vitin 1966 kremtohet dhjetë vjetori i Shtëpisë për Zbutjen e Vuajtjes – Vepër e atë Pio-s – kurse një vit më vonë festohet tetëdhjetë vjetori i datëlindjes së themeluesit.

Gjendja shëndetësore e atë Pio-s për fat të keq gjithë e më tepër keqësohet, kështu që i lejohej kremtimi i meshës ulur: në vitin 1968, pesëdhjetë vjet nga lajmërimi i stigmave, është ftuar takimi ndërkombëtar i lutjes. Vetëm pak pas përfundimit të kremtes, në natën mes datës 22 dhe 23. shtator, atë Pio vdes, i përcjellur me dhimbje të pangushëllueshme dhe të paskajshme të shumë besimtarëve të tubuar nën dritaren e dhomës tij. Ceremonia e varrimit ishte më 26 shtator, me pjesëmarrje të dhjetëra mijëra besimtarë të pikëlluar të cilët nxituan nga mbarë bota që ta shohin dhe japin nderin e fundit tokësor trupit të atë Pio-s nga Pietrelquina.

Trashëgimia e atë Pio-s dhe procesi i lumturimit

Trashëgimia e atë Pio-s është e madhe. Spitali është njëri ndër institucionet shëndetësore më të efektshëm dhe rëndësishëm në Itali, qendër shëndetësore dhe hulumtuese me rëndësi ndërkombëtare.

Gjurma e themeluesit do të mbesë e pashlyer në vitet në vijim, jo vetëm në spital “*Shtëpia për Zbutje të Vuajtjes*”, por edhe në të gjitha nismat paralele të cilat atë Pio dhe ndjekësit e tij përjetshëm dhe vazhdimisht promovuan sipas dëshirës dhe frymëzimit të themeluesit dhe atit shpirtëror.

Gjatë viteve janë organizuar tubime të shumta ndërkombëtare mjekësore: në Itali dhe mbarë botën po rritet numri i Grupeve të Lutjes (të cilat i pranoi papa, në audiencë të posaçme, në tetor të vitit 1983), vazhdon të botohet *Fletushka* e Shtëpisë për Zbutje të Vuajtjes si dhe libra të shumtë të cilat flasin mbi Veprën dhe përshpirtërinë e atë Pio-s dhe veprimtarinë e spitalit.

Me 20 mars 1983 filloi procesi për lumturimin e atë Pio-s. Punët e komisionit përfunduan në mbarim të vitit 1997; U shpall i Lum më 2 maj 1999, ndërsa Shenjtë më 16 qershor 2002 nga papa Gjon Pali II.

Feja e madhe që e nxiste shpirtin e paqetë, të mirë dhe tejet të rraskapitur të atë Pio-s shprehet më së miri nëpërmjet lutjes dhe meditimit të pandërprerë. Mësimi i atë Pio-s do të mbesë për të gjithë trashëgimi e pashlyer:

“Lutja është arma më e mirë të cilën e kemi, ajo është çelësi i cili hap zemrën e Hyjit. Jezusi duhesh t'i drejtohesh me zemër, e jo vetëm me gojë; më tepër, në disa rrethana të caktuara duhesh t'i flasësh me zemër – lutja gjithmonë duhet të jetë e qëndrueshme, sepse qëndrueshmëria tregon fenë.

Lutja e shenjtëve në qiell dhe shpirti i të drejtëve në tokë, janë erëkëndje e cila nuk do zhduket askurrë.”

Dom Gjovalin SIMONI
Shkodër

PËRSHPIRTËRIA DHE DEVOCIONI NDAJ “Zojës së Këshillit të Mirë”: PAJTORJA E POPULLIT SHQIPTAR

Jam shumë mirënjohës që në këtë Jubile të 550 vjetorit të shpërnguljes së figurës së Zojës së Këshillit të Mirë në Genazzano, të mund të paraqes një përmbledhje të shkurtër të një copëze të pashprehur të shpirtit të shqiptarit i cili në të mira dhe në të vështira ra përmbys tek këmbët e Zojës dhe iu lut për çdo nevojë. Prandaj nuk është e lehtë të përshkruash me fjalë botën e ndjenjave dhe aq më tepër se kjo botë e brendshme herë-herë është aq misterioze sa që as mendja nuk mund ta shpjegojë sepse ka të bëjë pikërisht me fenë që tejkalon dimensionin thjeshtë intelektual apo historik. Kjo përshpirtëri dhe ky devocion ndaj Zojës së Këshillit të Mirë, ose siç thirret edhe në shenjë dashurie amnore: “Nëna e Këshillit të Mirë”; e ka përcjell me një mbrojtje dhe përkrahje të vazhdueshme popullin shqiptar në travajet e panumërta që ka kaluar.

Përveç dimensionit devocional dhe historik lidhja e besimtarëve me figurën e Zojës nuk është thjeshtë një besëtytni (supersticion) por është tregues i një feje të fortë që nëpërmjet Saj të zhytmi në misteret e Zotit duke besuar pikërisht se është Ajo që na mëson të dëgjojmë “gjithçka Ai të na thotë”; sikurse iu thotë shërbëtorëve në Dasmën e Kanës. Nga ky episod biblik Zoja Mari merr edhe titullin që nderohet në mbarë Kishën si “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Dëshiroj që ta vazhdoj reflektimin tim duke u ndalur në disa përmasa kryesore; siç është ai teologjik nga ku mund të kuptojmë më së miri edhe rëndësinë e përshpirtërisë mariane. Pastaj dëshiroj të ndalem tek mbrojtja dhe përcjellja që Zoja i bën popullit shqiptar sidomos kur kalon në momente të vështira historike ku feja e disa burrave e grave është sprovuar në zjarrin e përgjakur; kurorë martirizimi. Dhe në fund dëshiroj që të shohim bashkë fenë e një populli të thjeshtë që ende sot vazhdon ti bie ndore Zojës së Këshillit të Mirë, për të kërkuar këshilla, strehim dhe forcë në hapat e jetës dhe në vështirësitë e ndryshme.

Dimensioni teologjik dhe kishtarë i përshpirtërisë ndaj Zojës

Devocioni ndaj Virgjëres Mari nuk mund të shkëputet nga themeli teologjik i fesë së krishterë; konkretisht nga besimi në Trininë Shenjte sepse edhe misioni i Marisë është i përfshirë në planin shëlbimprurës që Ati ka menduar prej amshimit si bashkëpunëtore në planin trinitar duke sjell në botë Birin e Vetem, Jezu Krishtin, vehtjen e dytë, për virtyt të Shpirtit Shenjt. Duke u nisur nga kjo bazë teologjike, Maria, merr në Kishë një vend të veçantë nderimi dhe devocioni si Nëna e Tenzot dhe Nëna e Kishës duke na dhënë neve kështu mundësinë e një lidhje sa njerëzore aq edhe hyjnore me personat e të shenjtërueshmes Trini.

Kisha i ka ruajtur me xhelozi edhe festat e

solemnitetet të cilat janë të lidhura ngusht me historinë e shëlbimit. Kështu, solemniteti i *Lajmërimit të Zotit* (Nunziata) siç thirret në gjuhën popullore e datës 25



mars, lajmërimi i Zotit. Por edhe festa e të *Ngjiturit e Zojës në Qiell* që i bie me 15 gusht.

Pas këtyre dy solemnitetëve, janë edhe festat e tjera si p.sh., festa e *Vizitës së Zojës* që i bën Elizabetës me 31 maj, festa e *Lindjes së Zojës*, me 8 shtator. Pastaj festat që lidhen me devocionin popullor si Festa e *Zojës Rruzare* e 7 tetorit, një festë shumë e dashur për popullin tonë sepse lidhet në një mënyrë shumë të thellë me devocionin ndaj Lutjes së Rruxares, si lutje ndërmjetësuese për familjet. Vlen të përmendet se kjo lutje, pra rruzarja ka qenë lutja më e dashur për familjet shqiptare; arma më e fuqishme, ashtu siç quhet nga populli. Ajo e ka përcjellë familjen në çdo vështirësi dhe në çdo gëzim. Gjithashtu roli i saj siç na thotë edhe Nënë Tereza është se e mbanë familjen të bashkuar.

Në këtë kuadër historik dhe kishtarë zë fill edhe lindja e titullit të “Zojës së Këshillit të Mirë”. *Mater Boni Consilii*, në latinisht është titulli i lashtë që thirret Maria, Nëna e Krishtit. Ishte Papa Leoni XIII që në vitin 1903 e fut këtë titull në listën e Litanive Lauretane në të cilën lutej Virgjëra Mari. Brenda këtij titulli gjendet krejt urtia e jetës njerëzore e Zojës por edhe e jona. Sepse Maria është Arka që mbajti Urtinë, Jezu Krishtin. Në fund është ajo që në Dasmën e Kanës, i këshillon dasmorët me këto

fjalë: “bëni çka t'u thotë!”.

Duke u kthyer prapa në Shqipërinë e pushtuar tashma nga Turqit, situata fetare sa vinte e vështirësohej. Shumë besimtarë detyroheshin ose të iknin në Itali, kush kishte mundësi ose të largoheshin në male ku vështirë do të ndiqeshin nga pushtuesit osman. Duke parë këtë gjendje qoftë të klerit ashtu edhe të besimtarëve, disa fillonin të bënin kompromis me idealet e pushtuesve. Fillon të përhapet kështu laramanizmi. Nisur nga ky fonemen i parregullt, prelatët e dioqezave të asaj kohe thirren një Kuvend mbarë shqiptarë në Mërkinjë të Lezhës në vitin 1703. “Pas këtij Kuvendi i mbajtën edhe dy të tjerë ku në Kuvendin e Tretë që u mbajt në Shkodër në vitin 1895, propozuan si mbrojtëse e Pajtores të Shqipërisë Virgjinen Nanë të Këshillit të mirë, e njoftun gjithashtu si Zoja e Shkodrës. Ky vendim u mor njizani dhe iu parashtrur Atit të Shejt, Papës Leoni XIII, dhe jo vetem mori përlqimin, por përveç kësaj kje shpallë 26 prilli si ditë kremtje për dioqezet e Shqipnisë”. (Willy Kamsi)

Është me rëndësi teologjike dhe ungjillore se si Maria është e vetmja figurë shpirtërore që u qëndron pranë shpirtit të besimtarit shqiptarë edhe në momentet e vështira. Prandaj besnikëria e Marisë deri tek këmbët e Kryqit është shenjë profetike se si ajo bëhet edhe për popullin e martirizuar shqiptar qoftë nga pushtimi osman qoftë edhe nga diktatura komuniste. Ajo është aty, tek këmbët e kryqit dhe na mëson se si të jemi besnik edhe ne deri në fund.

Dimensioni martiriologjik për gjatë historisë

Është pikërisht ikona e Marisë tek këmbët e kryqit bashkë me Gjonin, që bëhet në një farë mënyre edhe për popullin e martirizuar shqiptarë një mbështetje, por në mënyrë të veçantë edhe për martirët e sapo shpallur nga Kisha Universale, pikërisht në Katedralen e Shkodrës, 5 nëntorin e vitit 2016.

Kam dashur ta filloj këtë kapitull duke e titulluar pikërisht kështu: Maria, Mbretëresha e martirëve, titull ky i Virgjëres Mari e njohur dhe i lutur në litanitë e Zojës; sepse Maria u ka prijë Apostujve dhe secilit besimtarë në rugën e Kryqit. Ka qenë ajo që ka qëndru tek këmbët e Kryqit të Birit të saj duke përshpëritur fjalët e Simeonit plak “një shpatë do ta shporojë shpirtin”, që i referohej pikërisht këtij momenti dramatik të kryqëzimit. Por edhe në dimensionin kishtarë, Maria ka qenë ajo që në vuajtjet e kryqit ka pritur lindjen e Kishës: “Qe Nëna jote! Qe biri yt”- fjalët e Krishtin në kryq.

Me siguri se Maria është edhe Mbretëresha e Martirëve të Kishës në Shqipëri. Vetë imazhi ose figura simbolike e menduar për Lumnimin e 38 Martirëve, ka në qendër dhe në krye Zojën e Këshillit të Mirë. Ajo duket sikur i strehon nën mantelin e saj të gjithë bijtë e bijat e saja. Bëhet strehë në vuajtje deri në martirizim. Por edhe vetë Martirët e Kishës në Shqipëri ishin të vetëdijshëm për këtë lidhje të fortë e personale por edhe afektive me Marinë, si me nënën e tyre. Jo më kot, shihet nga lutja dhe poezitë e tyre se si janë drejtu Virgjëres Mari. Nga ana tjetër ata kishin edhe bindjen e thellë se nuk janë vetëm sidomos në çastin i dhimbjes, sepse e

dinin sepse Zoja e Këshillit të Mirë do t'i shoqërojë edhe ata deri tek këmbët e kryqit. Vlen të përmendet këtu edhe fakti se pjesa më e madhe e këtyre klerikëve kanë thënë meshën e parë ose janë shuguruar në Ditën e Zojës së Këshillit të Mirë, ose në Shkodër ose në Gjenacan.

Desha me fillu me citimin e një poezie të Imzot Vinçens Prennushit me titull “*Mretnesha e Majit*” marrë nga vëllimi poetik i tij “*Gjeth e lule*”:

...Pra, fronin ku t'i a ngrehim?

Atje per bri kalaje,

ku uzdajat na t'gjitha i shprehim,

ku t'fashamet tona i ndjeu: ku vetë na u ba muroje,

ku vetë na muer nen mproje,

verigat ku na i preu.

Aty ku kta uraten e thoshin përpara Zojës,

vringllojshin trimnisht shpaten,

tuj britë: mos u ligshito, Shqypni;

prej rrethit t'qiellit, e amla Nanë e Kshillit,

shqyptarët per veti i do.

Imzot Prennushi, në kry të listës së 38 martirëve shpreh në këtë poezi shpirtin dhe besimin e çdo besimtari shqiptarë që diti jo vetem t'i ndërtojë një shenjtërore Marisë, por pikërisht në këtë shenjtërore shprehu uzdajen, shpresën e ofshamat e veta në momentet më të vështira.

Po edhe poeti madh françeskan Padër Gjergj Fishta i thur lavd e lutje Zojës së Shkodrës tuj u drejtu kështu:

“Kur përmbrenda atij Tempulli të ri/ mu nën bedena t'Rozafatit kushtu/ N'gjuj shoh shkodranin ulë me përvujtni/ mbjen n'mend se Zoja e Shkodrës m'thonë mu!”

Por edhe në momentet e vështira që me siguri ka kaluar populli shqiptarë dhe Shkodra gjithashtu, Fishta është i bindur për lidhjen e pandashme që ekziston mes Zojës dhe Shkodrës duke e shprehur në varg kështu:

“E kurrë nuk e la që pingul Shkodrën/ shigjeta e annikut t'a qëllojë/ e vërtet asht kjo:/ që Shkodra asht e jemja e unë jam i sajë.”

Patjetër që poezia është shprehje e shpirtit artistik, por me siguri që ky frymëzim buronte nga thellësia shpirtërore e këtyre njerëzve të mëdhenj që siç e themi ne është lutje, pra një dialog personal me Zotin.

Një Martir tjetër, Poeti i amël në natën e zezë, por edhe agimi i bardhë; në agoninë e arrestimit të Lumit Dom Ndre Zadeja pikërisht me 24 mars 1945, një natë që i përgjanë shumë natës së agonisë së Krishtit në kopshtin e ullaive ku lutej e dërsitej gjak; ai Dom Ndre bashkë me shokët e qelisë nën ritmin e fesë dhe me tingullin e shpresës, këndonin këngën që u besonte duarve të Nënës qiellore: “*Nana e Tenzot e Nana jonë, ty po ta falim jetën tonë!*” Edhe ato në gjurmët e Mësuesit qiellore, që pasi këndoi himnin u nisën drejt malit të ullaive, ashtu edhe Dom Ndre bashkë me shokët Martirë të sigurt në Mbrojtjen qiellore të Nënës së Këshillit të mirë u nisën drejt Rrëmajit, murit të pushkatimit për t'u takuar me Mbretëreshën e Martirëve në lumninë e qiellit.

Devocioni popullor dhe sakrificat ndaj Zojës së



Këshillit të Mirë

Me siguri që dëshmitarët më të besueshëm të fesë së besimtarëve që përluteshin dhe përlutet akoma sot tek Shenjtërorja e Zojës, janë veç Zoti që sheh zemrat e njerëzve dhe mirënjohja e thellë e çdo besimtari që ka nxjerr hire nga kjo Nënë qiellore. Ndoshta kjo lidhje amnore e ka bërë shpirtin e popullit tonë një xhevahir i çmueshëm i cili ka ditë me i qendru besnik Zotit edhe në momente të vështira.

Vendndodhja gjeografike e shenjtërores është shumë domethënëse, sepse është në dalje dhe në hyrje të qytetit. Zoja e Këshillit të Mirë, i përcjellë bijtë e vet por edhe i mirëpret në gjirin e saj ato që kthehen. Ajo është një shenjtërore pelegrinazhi sepse aty ndalet i huaji e përshëndet Zojës, aty ndalet emigranti kur niset për në dhe të huaj e ia porosinë Zojës rrugën e mbarë. Aty shkon nëna për t'u lutë për fëmijët e vet, aty shkon baba për t'i besuar familjen e vet. Aty shkon i sëmuri, por aty shkon edhe falënderuesi që nuk ia humb nderin Zotit për të mirat që i ka ba. Përveç *shtegtim* që është një aspekt shumë i rëndësishëm i përshpirtërisë ndaj Zojës, është edhe *rruzarja* në familje që e ka lidhur dhe bashkuar shumë familjen me Zotin dhe më njeri-tjetrin. Sa herë edhe në këmbë, bile edhe nga shumë fshatra përreth Shkodrës edhe më larg në kushte e në kohë të ndryshme besimtarë të shumtë kanë shkuar në këmbë, ndoshta edhe zbatuar, por me devocion në zemër që t'i kushtonin Zojës një qëllim të veçantë.

Familje të tëra dhe fëmijë që në djep i kushtoheshin dhe i kushtohen Zojës së Këshillit të Mirë. Është bukur të shikosh sidomos në muajin maj, muaj që tradita kishtarë ia kushton Zojës për nder të Zojës së Fatimas që është me datë 13; dhe që këtë vit ka 100 vjetorin e shfaqje0073. Është një rastësi por edhe një shenjë se Zoja nuk mund të

mbyllet vetëm në kufijtë vendor por ajo është Nëna e gjithë njerëzimit.

Me siguri që pas shpërnguljes së figurës nga Shkodra për në Genazzano, është përceptu një farë vajtimi dhe gati largimi nga besimtarët shkodranë e më gjerë. Prandaj kemi disa forma pak melankolike por edhe të përvajshme.

“Qysh njat ditë që na u largove/ një mijë të zezat na kanë mblu/ kthe o Zoja e këshillit të mirë/ na prij në paq të hyjnishmit hirë/. Disa herë edhe me lot përfaqë thirrej kthimi i fugurës së Zojës. Patjetër që brenda kësaj drame ndodhet edhe persekutimi i tmerrshëm i kohëra të ndryshme të popullit shqiptarë.

Por nga ana tjetër shpirti i Shqiptarit ishte i bindur për mbështetjen dhe praninë e Nënës qiellore që i gjendej gjithmonë pranë. Dëshiroj ta përfundoj me një poezi të një autori anonim që personifikon çdo besimtarë i cili shkruan:

*“Thonë ke ik,
larg je mërgu!...
Jo, Zoja e Shkodrës
askund s'ke shku.*

*Atje tej detit
ka shku ikona
Zoja e Kalasë
je në zemrat tona.*

*Ballë pushkatimit
Ty t'kishim n'gojë
fjalët e fundit
n'dore tande Zojë.*

*Merre këtë lule
që ta punova
në shpirt më lindi
Ty ta kushtova.*

*S'do i vë nënshkrim
emër kurrfarë
ta dhuron, Zojë,
Ty një shqiptarë.*

*Ty amanet
ta la shqipninë
o Zojë e dashtun
na kthe lirinë!
Se përtej detit
ka shku ikona
Zoja e kalasë
je n'zemrat tona!
(Një shqiptar-Shkodër, 1989)*

(Konferencë shkencor Ndërkombëtare, “Zoja e Shkodrës Drita e Shqypniis”, kushtuar Zojës së Këshillit të Mirë, më rastin e 550 vjetorit të shpërnguljes në vitin 1467, për në Genazzano, organizuar në Shkodër më 22. Prill 2017).

Don Anton UKA
Shkodër

KOMUNIKIMI - NEVOJË E DOMOSDOSHME

Pjesë nga Besëlidhja e Re (Mk 7, 31-37), **rreshti: 31** Pastaj doli prapë nga krahina e Tirit, e nëpër Sidon, erdhi drejt detit të Galilesë në krahinat e Dekapolit.

Reshti: 32, *I sollën një shurdhaman që mezi fliste dhe iu lutën ta vërë dorën mbi të.* **Rreshti: 33** Ai e ndau prej popullit veçmas, ia futi gishtërinjtë e vet në veshë, me pështymë të vet ia preku gjuhën. **Rreshti: 34**: i drejtoi sytë kah qielli, psherëtiu dhe i tha: “Effatha - që do të thotë: “Çelu!”. **Rreshti 35**: E menjëherë iu çelën veshët e iu zgjidh pengesa e gjuhës dhe foli rrjedhshëm.

Rreshti, 36: Jezusi u urdhëroi të mos i tregojnë askujt. Por, sa më tepër që ai ua ndalonte, ata aq më tepër e shpallnin. **Rreshti, 37**: Të mrekulluar mbi çdo masë thoshin: “Gjithçka bëri mirë!” “Ky po bën të dëgjojnë të shurdhëritë e të flasnin memecët!

Para se të kalojmë te gjestet e Jezusit që pasojnë mrekullinë e shërimit të shurdhamanit belbacuk, e konsideroj shumë të rëndësishme të ndalemi te vargu 32, përmes të cilit Shën Marku ungjilltar paraqet gjendjen apo situatën e një njeriu, që, në një farë mënyre, simbolizon apo paraqet situatën e njeriut dhe të shoqërisë të të gjitha kohërave. Shprehja ‘*i sollën*’, domethënë ia paraqiten një problem konkret, një situatë, një vështirësi, një sëmundje të një njeriu shurdhamanë dhe memec. ‘*I sollën*’, domethënë vendosen mos ta mbajnë të fshehur sëmundjen që e rëndonte jetën e këtij njeriu dhe vuajtjen e të gjithë atyre që jetonin me të. Domethënë e kuptuan se njeriu për të dalë nga sëmundja, ka nevojë të shkojë në drejtim të një

mjeku, ka nevojë të vihet në lëvizje, pra, mos të qëndrojë i kërrusur mbi sëmundjen e tij. ‘*I sollën*’ domethënë vendosen t’ia komunikojnë Mjekut pjesën me të vështirë dhe më të dhimbshme të jetës: sëmundjen. Kështu që kjo pjesë e skenës na tregon dhe dëshmon se të komunikosh gjërat intime të jetës është shumë e vështirë, por njëkohësisht e bukur dhe çliruese. Kjo domethënë se komunikimi mbetet një sfidë e madhe për njeriun që patjetër duhet ballafaquar.

Po i njëjti rresht tregon arsyen pse ia sollën Jezusit këtë shurdhaman që mezi fliste: ‘*iu lutën ta vërë dorën mbi të*’. Ia sollën Jezusit! Edhe kjo e ka një domethënie dhe një kuptim të madh shpirtëror dhe psikologjik. Fakti se ia

sollën Jezusit, nuk përjashton mundësinë që këtë njeri më parë mund ta kenë dërguar te njerëzit tjerë dhe në vende tjera, ndoshta mund ta kenë dërguar te mjeku, te psikologu, te njerëzit dhe në ambiente që mendohej se do ta shërojnë. Nuk është për t’u çuditur nëse Jezusi ka qenë personi i fundit nga i cili kanë kërkuar ndihmë. E rëndësishme është që janë drejtuar drejt Tij dhe kanë



kërkuar që t'i shtrijë duart mbi të. Shtrirja e duarve simbolizon bekimin, pra, e kanë sjellë te Jezusi për ta bekuar (ad benedicendum), që domethënë, për ta thënë fjalën e mirë mbi të, atë fjalë që shëron, që hapë veshët për ta dëgjuar fjalën dhe hapë gojën për ta dëshmuar atë, ngjarje këto që do t'i shohim në vijim.

Vargu tridhjetetë dhe tridhjetekatër paraqet gjashtë gjestet apo gjashtë veprimet që Jezusi përdor në takimin me këtë njeri.

1. E ndau veçmas.

Pedagogjia e Jezusit është jashtëzakonisht domethënëse në takimet e tija me kategori të ndryshme të njerëzve. Mënyra sesi ai vepron dhe sesi iu qaset problemeve është shumë e rëndësishme. Shprehja e ndau veçmas tregon dëshirën vepruese të Jezusit për ta njohur këtë person, për ta krijuar një intimitet me të, një miqësi që rrëzon çdo formë paragjykimi, një miqësi që dhuron besim, një miqësi që për metër matës nuk e ka orën (kohën), por dashurinë.

2. Ia futi gishtërinjtë e vet në veshë. Ky gjest i Jezusit jo vetëm se duket i çuditshëm, por realisht është i tillë. Është një gjest shumë delikat, por i domosdoshëm. Njeriu shumë herë nuk dëshiron të dëgjojë për faktin se është i rrethuar nga zhurma, nga fjalë të mbushura me armiqësi, nuk dëshiron të dëgjojë, sepse ndjehet i refuzuar dhe i kritikuar. Preferon t'i mbyllë veshët apo të qëndrojë i shurdhër, për faktin se fjalët që i dëgjon nuk i dhurojnë qetësi, harmoni, gëzim, paqe. Vendosja e gishtërinjve në veshë, është gjesti përmes të cilit Jezusi dëshiron t'i tregojë njeriut të sëmurë, që përmes fjalëve, dëshiron të depërtojë në veshët e tij, pra në jetën e tij, pra tregon kujdesin dhe dashurinë, butësinë dhe pranimin. Ky gjest, sipas murgut dhe psikologut të famshëm gjerman Anselm Grün, dëshmon se Jezusi përmes fjalës



dëshiron të arrijë në jetën e këtij njeriu, përmes fjalës dëshiron ta krijojë bashkimin me të. Gishtërinjtë në veshë tregojnë po ashtu se përmes fjalëve të tjerëve dëshirojmë t'i zbulojmë dëshirat intime të tijat, nevojën e tij për dashuri dhe për Hyjin.

3. Me pështymë e vet ia preku gjuhën.

Prekja e gjuhës me pështymë është njëri ndër gjestet më intime që njeriu mund të ketë me njeriun tjetër. Ky gjest shpreh dashurinë e thellë të nënës ndaj fëmijës, e cila me lehtësi ia futë fëmijës gishtërinjtë në gojë, që së bashku me pështymë t'ia nxjerrë edhe llomin apo dheun që fëmija ka vendosur në gojë. Shpreh dashurinë e të martuarve dhe dashuruarve që me puthjet e tyre prekin pështymen e njëri tjetrit. Këto prekje e zhdrivillojnë gjuhën dhe e lehtësojnë komunikimin. Pa këto gjeste, thoshte kardinal Martini, nuk mund të komunikohet – dhurohet dashuria. Kjo shprehje e Jezusit na mëson, po ashtu, që komunikimi të jetë sa më i lehtë, sa më i mirë, sa më i drejtë dhe sa më i sinqertë, është e nevojshme të krijohen kushtet paraprake, është e nevojshme të përgatitet tereni; është e domosdoshme të krijohet atmosfera e komunikimit, përndryshe fjala mbetet në fyt e njeriu mbyllet. Ka njerëz që nuk flasin, sepse

kanë frikë të ekspozohen, kanë frikë të dalin në dritë, kanë frikë, sepse e kanë kuptuar që fjala na zbulon, na tregon kush jemi, na tregon çka dëshirojmë dhe çka nuk dëshirojmë.

4. *I drejtoi sytë kah qielli.* Përmes këtij gjesti, Jezusi dëshiron t'ia mësojë të sëmurit si dhe të gjithë atyre që e rrethojnë domethënien e thellë të të folurit dhe të të dëgjuarit. Misteri i fjalës qëndron në komunikimin e realitetit të Hyjit, të lidh me qiellin, thoshte Anselm Grün. Fjalët nuk janë vetëm instrument informimi. Ato na krijojnë, na formojnë, janë pjesë e komunikimit të Hyjit me ne. Të thuash fjalë domethënëse të thuash diçka hyjnore, domethënëse t'ia dhurosh Hyjin tjetrit. Në këtë fjalë qëndron misteri i hapjes.

Shikimi i Jezusit drejtë qiellit, sipas Carlo Maria Martinit, shpreh vuajtjen, dhembshurinë dhe pjesëmarrjen e Tij në sëmundjen e njeriut, të secilit njeri.

5. *Psherëtiu – nuhati.* Jezusi duke nuhatur mbi të, ia hapë zemrën, e lejon të hyj në jetën e tij. Nuk e trajton si të huaj, si të padenjë. Empatia (ndjeshmëria, dhembshuria) e Jezusit e çarmatos, rrëzon të gjitha barrierat. Jezusi ka dhembshuri për të, pra lejon që të lëndohet, që të vuajë, që të përfshihet nga vuajtja e tij.

6. *Effatha - që do të thotë: “Çelu! Vetëm pas këtyre gjesteve dhe pasi të ketë krijuar kushtet e favorshme, Jezusi mund t'i thotë: çelu, hapu, shërohu! Vetëm pasi t'ia ketë krijuar një atmosferë miqësie, intimiteti, besueshmërie, dashurie, shurdhmemeci (i sëmuri, i mbylluri, i kufizuar, i dëshpëruar, i frikësuar) mund të dëgjojë dhe mund të flasë me një lehtësi të paparë. Tani mund të dëgjojë dhe të flas, sepse është zgjidhur nga zinxhiri i frikës, i paragjykit, i zhurmës, i pështjellimit. Nga kjo paraqitje dhe nga kjo mënyrë e të vepruarit të Jezusit, kuptojmë se fjala e thënë mirë dhe në moment të mirë krijon bashkim, dhuron jetë, ngjallë dashuri, nxitë dëshmi.*

Nga ky episod biblik dhe nga ky person anonim i Ungjillit, që në një farë mënyre simbolizon të gjithë njerëzit e të gjitha kohërave dhe të gjitha vendeve, mësojmë të vetëdijesohemi për vështirësitë tona komunikuese dhe për nevojën tonë të përhershme që t'i lejojmë vetit të prekem nga duart, nga gishtërinjtë, nga gjuha dhe nga nuhatja e Jezusit, në mënyrë që të shërohem nga të gjitha bllokimet tona personale, familjare, shoqërore, shpirtërore, mendore dhe trupore.



Don Nosh GJOLAJ

Podgoricë

TË MPOSHTEN TË GJITHA KUNDËRSHTIMET

(Pjesa e parë)

1. Të mposhten murmurimat apo pakënaqësitë që i sjell dhembjeprurja

Fëmija ose foshnja kur e ndenj veten keq ose ka ndonjë dhembje fillon e qanë ose bërtet, po ashtu po qe se është e lodhur atëherë është edhe qaramashe dhe vajtues. Njeriu apo personi i rritur i frenon apo i mposhtë emocionet qofshin ato të dhimbjes apo ato që e lëkundin në baraspeshën e jetës së përditshme. Kuptohet se njeriu i kësaj moshe e kupton zanafillën e dhimbjes apo të vuajtjeve dhe me arsyen e mendjes së shëndoshë i tejkalon, duke ndërhyrë për t'i eliminuar në një mënyrë apo në tjetrën, bie fjala shkojmë në vizitë te mjeku ose i përdorim hapat kundra dhimbjes etj. Por gjithherë mbetet tundim i përherëshëm, që nuk e kursen as personin apo individin e rritur, që shumë lehtë dhimbja apo ndonjë sëmundje të na shpien në tërheqjen apo kundërpërgjigje, që nuk është asgjë tjetër përveç mekanizmi mbrojtës me të cilin një person kthehet mbrapa, tek një sjellje më e hershme dhe më e papjekur që është edhe karakteristika e fëmijëve parashkollor. Për këtë arsye është mjaft me rëndësi të zgjidhet konflikti, dhimbjet apo vuajtjes, sa më shpejt që të jetë e mundur, përpara se të kalojnë në fazën e neurozës apo ndonjë sëmundjeje tjetër psikike apo psikosomatike. Po ashtu është shumë e lehtë të shfaqet

kundërpërgjigja edhe në sferën e dashurisë dhe është e theksuar në gjirin martesor posaçërisht te partnerët të papjekur emocionalisht apo nga ana afektive, si në fazën e fejesës, partneri kishte një kujdes të veçantë ndaj të dashurës, a tani pas martesës ky kujdes fillon të zbehet. Ose në rastin tjetër, partneri pëson ndonjë sëmundje të rëndë, siç është paraliza nga fatkeqësia e trafikut dhe individi është i ngujuar në kravatë, thuajse për tërë jetën, ashtu mbetet i pa lëvizur etj., në shumicën e këtyre rasteve, pacienti tërhiqet apo kthehet mbrapa duke e riaktivizuar mekanizmin mbrojtës (regresioni-kundërpërgjigja) në atë fazë, i përngjan fëmijës apo foshnjës në stadin e parë të jetës, në të cilën është i varur nga mjedisi dhe kujdesi i tjetrit.

Vetvetiu kuptohet se një situatë e këtillë e vë në provë jetën e martesore! Në këtë rast nuk është në provë vetëm dashuria por edhe sjellja e partnerit ndaj partnerit të sëmurë. Në “kopshtin” martesor shumë lehtë krijohet vendi i përshtatshëm e i volitshëm për sëmundjet e llojllojshme recidive, që nuk janë asgjë tjetër veç rishfaqje e ndonjë sëmundje që rikthehet. Në rastet të këtilla shihet mirë teknika bardhë e zi në të cilën verifikohet pjekuria emotive ose afektive e njeriut apo e individit, pikërisht çiftit martesor. Individi që pëson fatkeqësinë apo, ai që kujdeset për të, shumë lehtë mund të bie në provë, fjala vjen, ai apo ajo e fajëson



spitalin dhe personelin e tij, që nuk kujdesohen për pacientin në mënyrë të mjaftueshëm edhe pse në realitet personeli i kryen detyrën me saktësi e ashtu si duhet, për ta shëruar pacientin në fjalë. Për këtë fakt çifti martesor duhet të vetëdijësohet deri në cilën masë zotërohet toleranca apo durimi dhe kur fillon të keqpërdoret dashuria e tjetrit, sepse një është dëshira e një tjetër është realiteti, dhe nuk bënë të kërkohej jashtë kufijve të mundësisë as të spitalit në rastin tonë, as nga çifti martesor për t'u ngujuar pranë partnerit të sëmurë. Pse unë jam i palëvizshëm apo i sëmurë, vallë a do ta dhunojë edhe atë gjysmën tjetër, në këtë rast partnerin, duke kërkuar prej tij rolin e mirëbërësit në mënyrë të pakufishme, që me një fjalë i kalon të gjitha kufijtë e dashurisë e njerëzisë? Po qe se e pranon çifti martesor ta lozin rolin e mirëbërësit qoftë të nënës ose të babës, atëherë edhe ai do të hyjë në rrugën e rrezikshme, e cila jo vetëm se do t'ia shkatërroj harmoninë e brendshme por edhe do ta humb baraspeshën e jetës e mos të flasim për bashkësinë martesore e cila në këtë mënyrë do të dështoj. Sepse vet partneri i shëndosh, detyrohet të sillet me partnerin e sëmurë sikur të ishte ai foshnje apo fëmijë, i cili reagon në çdo lloj sëmundjeje, mungese, dhimbjeje, mos durimi, e si fëmija e kërkon ta ketë tjetrin pranë vetes, si i tillë jo vetëm se është i mërzitshëm apo i bezdisshëm por bëhet i padurueshëm. Sjellja e tillë jo vetëm se shkakton, në personin e shëndoshë, në rastin tonë partnerit martesor, pakënaqësi por edhe gërdi e ngopje me bezdinë apo mërzinë e tjetrit. Në këtë mënyrë do të hyjë në rrathët magjik apo djallëzor nga ku nuk ka kthim mbrapa.

Disa herë e kemi theksuar se nuk ka njeri apo individ të përsosur po ashtu as shoqëri, me një fjalë, nuk ka ditë pa natë as natë pa ditë, ose nuk ka ditë pa terr, as terr pa ditë, atëherë është e kuptueshme se në çfarëdo bashkësie apo martese do të ketë patjetër ndonjë dhembjeprurje që sjellë njëfarë doze jo vetëm pakënaqësie por edhe shqetësime, hutime, neveri mos të themi panik apo frikë. Derisa është nën kontrollin e individit gjithçka është në rregull dhe normale, po qe se ndodhi që individit të humbë kontrollin ose baraspeshën e normales, atëherë edhe pse dozë e vogël, dhembjeprurja mund ta kalojë kufirin, pastaj mos të flasim për pasoja që mund të vijnë jo vetëm për individin në fjalë por edhe për bashkësinë e martesës. Tipi i tillë, i përngjanë topit të vogël boret i cili kur nisat të rrokulliset poshtë; në fillimit ishte i vogël, por gjatë rrugës rritet e zmadhohet aq sa bëhet i rrezikshëm për zhdukjen edhe të një fshatit në të cilin përplasat.

Individi bëhet i paafte për ta zgjidhë problemin në mënyrë të përshtatshme ose të natyrshme e spontane. Femrat zakonisht nga natyra janë mjaft të ndjeshme e lehtë i ngacmon me çfarëdo dhimbje, fjala bie, ajo është mjaft e ndjeshme dhe ngacmohet lehtë apo shqetësohet gjatë ciklit mujor (menstrual) në veçanti në ditën e parë të menstruacioneve. Gjatë kësaj faze femra është jo vetëm tejet e ngacmueshme por edhe pa disponuar, qoftë për dialog ose bisedë, qoftë për çfarëdo punët apo zgjedhjet e përbashkëta. Në këtë rast, ajo bënë mirë ta sinjalizojë shokun apo partnerin. Kuptohet se ata përpara bien dakord se si dhe çfarë sinjalesh do të përdor në këtë apo në atë rast. Bie fjala, gruaja e varë flamurin me ngjyrë të verdhë mbi krevatin e fjetjes apo ndonjë vend të dukshëm. Ose ndonjë shenjë apo simbol tjetër, për shembull në rastet e tilla në të kaluarën femrat e kanë përdorë fjalën për menstruacionit: "Lajmet nga Roma", ashtu tjetri, pikërisht partneri, e kupton. Partneri posa e kupton sinjalin e dërguar nga e dashura, nuk shqetësohet por distancohet e nuk ndërhyrë as me biseda të kota apo therëse ose ngacmuese as me vepra por është madje edhe më i kujdesshëm, si në sjellje ashtu edhe për t'u orientuar duke krijuar mjedisin e volitshëm si për veten ashtu edhe për partnerin në fjalë.

Po qe se njëri prej partnerëve, bie në depresion ose është i ngarkuar jo vetëm fizikisht por edhe nga pikëpamja psikike duke e shoqëruar mërzia, ankthi mos të themi edhe frika. Në situatat e tilla nuk bënë të humbet durimi dhe arsyeja e mendjes së shëndoshë, as për t'u brengosur apo të kalohet në histeri ose në panik, sepse me sjelljet e tillë nuk e zgjedhin problemin por e ngatërrojmë edhe më tepër lëmshin ashtu të koklavitur. Në rastet e tillë është mirë të ruhet jo vetëm gjakftohtësia por edhe një farë distance derisa për rreth nesh të krijohet apo të kthehet harmonia e mëparshme. Po qe se njëri prej partnerëve nuk është i disponuar dhe një gjë e tillë zgjatë me ditë apo me javë, atëherë është e nevojshëm për t'u thelluar nga buron apo nga e ka zanafillën situata e krijuar, por kurrë nuk është e lejueshme për ta ngacmuar apo për ta thelluar sëmundjen, por me mjeshtri, me durim e mirësi ti vijmë në ndihmë partnerit, i cili në këtë rast vuan. Askurrë nuk është e preferuar që t'u ikim problemeve, posaçërisht atyre të brendshme, po ashtu, vlen edhe pohimi tjetër, as që t'i shtypim në sferën e nënvetëdijes, por me guxit të ballafaqohemi me to. Sepse çfarëdo ikje është vdekjeprurëse, që herët a vonë hakmerret jo vetëm ndaj individit por edhe ndaj bashkësisë martesore,

për shembull ikja apo strehimi në alkool, në drogë, apo në çfarëdo topitje tjetër, jo vetëm se nuk e çliron personin por edhe e skllavëron më tepër apo e tjetëron sepse herët a vonë bëhet i varur jo vetëm nga alkooli, droga, ilaçet, por mbet invalid apo gjysmak i pashërueshëm për tërë jetën e tij. Jo vetëm se shkatërrohet individi në fjalë, por ai si i tillë ndikon në mjedisin në të cilin jeton. Sipas statistikave në planetin tonë “Blu” 30% e njerëzve vuajnë nga alkooli e prej tyre 15% janë alkoolik të rënd. Po qe se personi merr guxim e ballafaqohet me problemin, sy më sy, atëherë mund të shpresojë se do ta realizojë jo vetëm qëllimin por do ti rikthehet shpresa e humbur, e suksesi nuk do t'i mungojnë as në rrafshin e dashurisë, as në rrafshin i vetëbesimit. Me tjera fjalë, sëmundja apo situata e zyrtë që e ka përfshirë njërin prej partnerëve do të

pamëshirshëm përplasit në të, por ai qëndron i palëkundshëm!” Të gjitha kalojnë e shkëmbi mbetet shkëmb. Ashtu vlen edhe për njeriun, e shkëmbi në fjalë nuk është asgjë tjetër përveç identiteti i njeriut, që e ka krijuar me kohë, qoftë identiteti kombëtar apo ai etiko-moral, fetar, të mendësisë ose pikëpamjeve të jetës apo filozofia e jetës.

Pikëpamjet e tilla janë të rëndësishme, në veçanti për çiftin martesor, të cilët duhen të vetëdijesohen dhe të mësohen për t'ia bartë njërit-tjetrit brengat, mërzinë dhe çfarëdo dhembjeprurjeje që sjellë. Kuptohet gjithherë e kurdoherë me sinqeritet, me dashuri dhe nga gjiri i tyre duhet jo të flaket murmuritja, nynykamja, pakënaqësia apo edhe ngarkesat e fajësimit. Sepse në shumë raste, i sëmuri ja hedh barrën tjetrit, duke e ngarkuar



zbehet dhe do të zhduket vetvetiu siç edhe ka ardhur në gjirin familjar ashtu edhe do ta lëshoi. Arma më efikase për raste të tilla është durimi, vetëbesimi dhe shpresa për një të ardhme më fatlume e më të freskët që nuk do të mungoj, sepse njeriu ose individi e ka çelësin e fatit në duart e veta. Fatlumturin nuk ta sjellë tjetërkush, as nuk të vjen vetvetiu, as nuk lindë, por ajo arritët me orvatjet të pa ndërprera dita-ditës. Siç thotë një anekdotë Japoneze: “Shkëmbi i madh qëndron i paluhatshtëm dhe i rrënjosur në vendin e vet, e mbi të kalon rrebeshi i shiut, i breshëritë, i borës, i vapës, i akullit, e retë e zeza e mbulojnë dhe murrani i

partnerin me barrë të rënd, jo vetëm se e dëmton veten por edhe tjetrin e së bashku hyrë në rrethin magjik praj kah s'ka as shtegdalje. Në të kundërtën po qe se frenohemi e njëherë ballafaqohemi me realitetin e dhembjeprurjes, atëherë as shpërblimi nuk do t'i mungojnë, sepse i rikthehet dhurata e fatlumturisë, e dashurisë dhe e harmonisë. Partneri i shëndoshë, i cili e ka baraspeshën normale, jo vetëm do t'ia lehtësoj barrën partnerit të sëmurë, por atij ja sjellë edhe ngrohtësinë, dashurinë dhe paqen duke shpresuar se një ditë do të shndris edhe dielli i dashurisë.

FIGURA E “ZOJA E SHKODRËS” MBETET PASURI E ÇMUAR KOMBËTARE

Konferencë shkencor Ndërkombëtare, “Zoja e Shkodrës Drita e Shqypniis”, kushtuar Zojës së Këshillit të Mirë, më rastin e 550 vjetorit të shpërnguljes në vitin 1467, për në Genazzano, organizuar në Shkodër më 22. Prill 2017.

Fjala e hapjes se rektorit te Shenjtërores “Zoja e Këshillit të Mirë”, Dom Artur Jaku.

Po hapim sot këtë konferencë të veçantë e njëkohësisht të rrallë për të hulumtuar më shumë mbi figurën e Zojës dhe historinë e saj të veçantë e po atë rrallë që gjallon mbi Kishën në Shqipëri.

Një histori 550 vjeçare, mistike, aktive, intriguese e mbi të gjitha, një histori frytdhënëse e bashkëshoqërimi shekullor e murosor në shpirtin tonë, si kolonë mbi të cilën është ngritur historia e lavdia e kishës në Shqipëri.

Kjo konferencë do të hedh më shumë dritë si mbi historinë e ikjes dhe mbërritjes në Genazzano të Zojës, po ashtu edhe mbi vet afreskun e shkëputur këtu e 550 vite më parë, me vakumin e lenë fizik e më gjithëplotësinë shpirtërore të pranisë.

Ikja, largimi, shkëputja, ruajtja, në këtë kompleksitet konteksti historik, kërkohet një kujdes për ti pranëvënë fjalën e duhur, në atë që unë do të quaja si fenomenin e shpërnguljes së Zojës së Këshillit të Mirë, ose Zojës së Shkodrës. Në rrethanat e krijuara historike, Zoja si krye Zojë e krye-prijëse, i priu historisë së persekutimit e detyrimit për tu larguar, siç bënë një pjesë e madhe e bijve, duke emigruar si kundër përgjigje e sfidës për të mos u asimiluar e për të vazhduar traditën



apostolike.

Kumtuesit në këtë konferencë shkencore të cilët gjej rastin për ti falënderuar për angazhimin,





do të hedhin dritë mbi Dritën, do të empirojnë mbi të mrekullueshmen, do të flasin për atë që flet më shumë me praninë e munguar, me forcën e heshtur në lutjet e fundit, apo akoma më tepër me pajtimin 550 vjeçar amnor.

Kur kremtorisht festoj 450 vjetori, I lumi dom Ndre Zadeja në krye, do të krijonte një reviste të përkohshme që do të botohej për disa vite me të njëjtin titull si kjo e kësaj Konference “Zoja e Shkoders, Drita e Shqypnjes”, duke ngritur në numrin e parë pyetjen. A lypet një e përkohshme e Zojës n'Shqipnie?

100 vite më pas, në kulmin e ceremonive për nder të këtij jubileu, lind e njëjta pyetje për rëndësinë e kësaj konference ndërkombëtare shkencore, për të cituar të njëjtën përgjigje. 'Lypet kjo konference për me mbajt në këmbë në popullin tonë këtë përkushtim ndaj kësaj të Lume, për më e rrit për ditë e ma fortë, e ma fort pas sodit për Zojën t'onë'.

Shën Benardi thoshte: Zoti mundet me ba një botë ma të madhe e një qiell ma të haptë, por me ba një Nanë ma të madhe e ma bujare se Nenën e Tenzot, nuk mundet.

Ky është nderi dhe lavdi që trashëgojmë, një nënë që nderohet në mbarë botën, një nënë emblemë historike, një Zojë të Shkodrës e një Shkodër e Shqipëri krejtësisht të Zojës.

Në këto festime, zemra mban edhe bengun e atij viti të mbrapsht 1967, që do të ndalonte çdo ceremoni fetare, e si rrjedhojë, s'do të kishte festë në 500 vjetorin e Zojës por vetëm ditë zije e mordi. Thuhet se krijimet ma të bukura janë fryt i dashurisë së zjarhtë apo i dhimbjes së fort, në Nenën e Këshillit të Mirë, këto dy forca janë shkri, duke na përçarur një fond të madh krijimesh, shkruar me gerrat e dashurisë së deshirur me kompozuar me notat dhimbjes së ndarjes, uratë e të përditshmes ditë të shekujve.

Kumtuesit vetëm pas pak do të trajtojnë, kontekstin historik, mrekullinë e shkëputjes,

përshtirësinë në popull, rrebeshet e kohës ndaj shenjtërores, por risia e krejt kësaj konference do të jetë vetë Zoja e Këshillit të mirë, teknikat si dhe paraqitjet e zbulimeve më të fundme. Edhe njëherë në cilësinë edhe të rektorit të Shenjtërores por edhe të komisionit organizativ, Ju uroj mirëseardhjen dhe i dëshiroj mbarësi e dobishmëri konference.

I bekuar qoftë prehri që e rriti, e i bekuar e fatlum prehri që e mban, gjithmonë zellshëm mbretëroftë përshtirëria ndaj Zojës së Këshillit të Mirë, si unazë që lidh tokën e qiellin, kombet dhe kohën.

Fjale përshëndetëse e Imzot Angelo Massafra, kryetar i konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë

Me shumë kënaqësi ju jap mirëseardhjen të gjithëve ju pjesëmarrës në këtë Simpozium që do të përkujtojë 550 vjetët e “ikjes” së Ikonës së Zojës së Shkodrës drejt Shenjtërores së Gjenacanos; një ngjarje historike mes legjendës dhe devocionit që, megjithatë, paraqitet si një mjet i dobishëm për rileximin e ngjarjeve politike, ushtarake dhe fetare të popullit tonë shqiptar.

Simpoziumi tashmë është hapur nga dom Artur Jaku të cilin e falënderoj për angazhimin e madh, së bashku me anëtarët e komisionit, në përgatitje të kësaj ngjarjeje; tani mua më takon detyra të përshëndes dhe të falënderoj që më parë të gjithë ata që kanë ofruar gatishmërinë e tyre për të shkruar në faqet e bardha të këtij Kuvendi me kompetencën dhe profesionalitetin e tyre.

Relatorë të nderuar,

Një “faleinderit” nga zemra për atë që do të na thoni dhe për pasurimin që me siguri do të kemi të gjithë ne prej kësaj dite reflektimi dhe bashkëndarjeje të njohjeve.

Nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'u uroj të gjithë pjesëmarrësve që t'i jetojmë gjallërisht këto orë së bashku. Gjithçka qoftë për lavdi të Hyjit dhe për rritjen e dashurisë sonë ndaj Nenës së Këshillit të Mirë ikona e së cilës jo vetëm na zbulon ëmbëlsinë amënore të Marisë por, siç kam pasur mundësi t'i shkruaj Selisë së Shenjtë kur kërkova praninë e një përfaqësuesi të saj për Festën e 26 prillit, në kryqëzimin e atij vështirimi dashurie mes Nenës e Birit, gjendet e gjithë Kisha që është në Shqipëri.

Urime dhe punë të mbarë.

Dom Nikë UKGJINI

Shkodër

SHENJTËRORJA “ZOJA E SHKODRËS” NË PËRBALLJE ME RREBESHET HISTORIKE (shek. XV-XX).

Të jesh me fat apo pa fat, nuk është as merita e as faji yt, apo i tjerëve, për arsye të kushteve dhe situatës, për shkak të pozitës apo situatës gjeografike, politike etj.. Shtrohet pyetja: çfarë mund të thuhet për figurën murale, “Zoja e Shkodrës Drita e Shqypniis”, e zhvendosur nga Kisha bri kalasë së Shkodrës për në Gjenacano në vitin 1467, e cila pas pak viteve u shpall figurë mrekullibërëse nga Papa Pali II, (1464-1471), duke marrë që në këtë kohë ngjarje me përmasa botërore.

Kjo histori e figurës së Zojës së Bekuar, domosdo na kthen në lashtësinë e Arbërisë, e në veçanti në qytetin e Shkodrës, i cili së bashku me Dioklenë, qytete të rëndësishme ilire, luante një rol shumë të rëndësishëm në fushën gjeopolitike të zhvillimit kulturor e pagëzimor në kohën romake. Me pushtimet sllave e avare në shek. VI, megjithëse shënohen degradime të këtij zhvillimi, me pranimin e krishterimit nga serbët në shek. IX-XI, evidentohen ndryshime pozitive në këtë pellg dhe ura ndërtimi të përbashkëta, të cilat kulmojnë sidomos në shek. XIII.

Shkodra me potencialin e saj, si nyje e lidhjeve në mes lindjes dhe perëndimit, vazhdon të ishte e rëndësishme edhe në kohën veneciane në fushën e humanizmit, kulturës, pikëpamjeve filozofike e teologjike, shkencore juridike, në anën ndërtimore e artistike e fusha të tjera. E gjithë kjo kuptohet nga dokumentet e kohës, kur flitet për qytetet e Arbërisë veneciane si: Kotori, Shkodra, Tivari, Ulqini, Shasi, Drishti, Lezha e Durrësi. Ky lulëzim perëndimor zgjati deri me daljen në skenën politike të pushtuesve osmanë të trevave shqiptare në fillim të

shek. XIV.

Në kudër të këtij zhvillimi duhet parë puna artistike më kulmore, e cila reflektohej në objekte fetare, si: kishat katedrale dhe kishat kanonike, abacitë dhe kuvendet e urdhreve kishtarë dhe shenjtërore të përmasave krahinore e më gjerë. Vetëm në shek. e XIII, në territorin e Arbërisë Venedikase shënohet se janë ndërtuar 30 kuvende dhe Kisha rregulltarësh nga mbretëresha Helena Azhuniane, e martuar me mbretin serb Stefa Uroshin. (1237-1272). Në këtë bum ndërtimesh, katër kishat e kuvendet françeskane, në Kotor, Tivar, Ulqin e Shkodër, janë ndërtuar nga motra e Helenës, Maria Anselmus, e cila qe varrosur në Kishën e Shën Mërisë në Ulqin në vitin 1307.

Provë për ndërtimin e kishave e kuvendeve në Shkodër janë shënimet e priftit shkodran Marin Barleci, i cili në ditarin e tij të botuar në Venedik në vitin 1504, duke folur për tmerrin e rrethimit të Shkodrës nga turqit, shprehet se brenda qytetit dhe përreth e qark, që më parë kanë funksionuar kishat në kala: Kisha katedrale e Shën Shtjefnit, e Shën Nikollit, e Shën Gjergjit; përreth kalasë: Shën Aponalit, e të gjithë Shëjtënve, Shën Teodorit e të Shëjtës Krygjë, Shën Pjetrit e Palit dhe e Shën Vlashit. Përtej Bune në Kasem, Kisha e Maria Magdalenës, Shna Prenes etj., dhe në jug-perëndim të kalasë bri murit qëndronte Kisha e Shën Marisë, e quajtur më vonë “Zoja e Këshillit të Mirë” si dhe në afërsi, Kisha e Shën Ilisë dhe e Shën Lazrit që gjendeshin në pjesën e Berdicës. Kishat e lartpërmendura të shek. XIII, i gjejmë edhe në



Regjistrin e Kadastrës dhe Koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417.

Faltoret Arbërore të Zojës së Bekuar në mesjetë

Përhapja e rregulltarëve në mesjetë në këtë zonë si: Bendediktinët, Dominikanët, Françeskanët, Karmelitanët etj., tërhiqte me vete, pos të tjerave, nderimin e madh që kishin ndaj Nënës së Krishtit, të lumes Mari, e cila në krishterim ka një rol tejet të rëndësishëm, sikurse perëndesha Vesta që kishte për Pellazgët e më vonë për Ilirët paganë. Me këtë synim duhen parë ndërtimet zinxhirë të manastireve kushtuar Zojës së Bekuar: të Shën Marisë në Budva, Zojës së Bekuar në Krajë, në shek. X dhe ajo e Dejës. Kurse në mesjetë kemi: kishën e Zojës, jashtë mureve të kalasë në Tivar, Kishën katedrale në dioqezën e Ulqinit, kishën kanonike të Shasit, Kishën e qytetit të Krujës, atij të Drishtit dhe kuvendin e kishës së *Zojë së Bekuar*, për të cilën jemi duke folur, ndërtuar jashtë mureve të kalasë, por brenda mureve të qytetit të Shkodrës, në shek. XIII.

Studiuesja Fatbardha Shkupi, duke cituar bizantologun e njohur Theofan Popa, shprehet se Abacia e Shirqit, e rindërtuar në vitin 1293, nuk ishte e stilit bizantin, por një faltore gotike e shek. XIII, sikurse edhe Kisha e Zonjës nën kala, e ndërtuar po në të njëjtin shekull, me të njëjtin stil dhe gurë të marrë nga kodra e kalasë së Shkodrës.

Për vendin se ku gjendej saktësisht në mesjetë Kisha e Zojës së Bekuar, e cila në dokumente figuron edhe si *Zoja Nunciatë* (Lajmërimi i Zojës), kemi informacione të ngjashme nga burime të ndryshme. Në dokumentin më të vjetër që kemi rreth toponimeve, *Regjistri i Kadastrës dhe Koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417*, duke përshkruar se ku gjendej te muret e qytetit shtëpia e Gajard Gajardit, e ku mbahej kripa e bashkisë, thuhej se ajo kufizohej edhe me Kishën e Shën Marisë së Shkodrës bri kalasë. Po kështu Kisha e Zojës përmendet, duke e përkufizuar pasurinë e Aleka Benkos në këtë zonë. Pastaj, duke përshkruar se ku gjendej vreshta e Piero Boiçinit, në *Vreshtat e Shkodrës*, në Berdicë, thuhej se kah pjesa e kalasë vreshta kufizohej me pasurinë e Kishës Zoja e Shkodrës. Po kështu edhe kur flitet për vreshtin e Proganit, e cila kufizohej me pasurinë e kësaj Kise.

Për vendndodhjen e këtij lokaliteti në mesjetë, shprehet edhe albanologu i shquar, Giuseppe Valentini, në shkrimin e tij botuar te revista *Leka*,

(nr. 8 1934), duke u shprehur se themelet e këtij objekti mesjetar duhet të jenë në patalokun e tanishëm, ku akoma sot qartas shihen gërmadhat e vjetra, apo sa pak në afërsi të lumit Drin, në vendin e një Teqeje, e cila sipas gojëdhënës, është ndërtuar në vitin 1649, si një konkurrencë dhe pengesë për Kishën “Zoja e Shkodrës”. Po kështu shprehet edhe historiani i parë shqiptar Dom Ndoc Nikaj, si kontribues i vyer i Shenjtërores. Në kujtimet e tij ai shprehet se *Kisha e Këshillit të Mirë*, sipas traditës popullore, duhet të ketë qenë aty ku sot janë gërmadhat e tepricat e vjetra, apo për shkak të madhësisë se Kuvendit, mund të ketë qenë shtrirë deri në shtratin e ujit të Drinit.

Zhvillimi i artit pamor në Dalmaci, ka pasur jehonën e vet edhe në Arbërinë veriore Venedikase në shek. XIII. Nga relacionet e ipeshkvijve dërguar Selisë së Shenjtë, kuptojmë se Kisha katedrale e Shën Gjergjit në Tivar ka qenë e stolisur me piktura të ndryshme murale madhështore. Po kështu dëshmohet edhe për kishat dhe kuvendet në dioqezën Shkodrës, Drishtit, Shasit etj.. Në relacionin e tij të vitit 1610, Marin Bici shprehet se Kisha e Shirqit ka qenë më e bukura e stolisur në tërë Shqipërinë. Po kështu flitet edhe për Kishën e Shna Prendës në Obot e shumë të tjera. Zhvillimin e artit të suksesshëm në mesjetë në Arbëri, e dëshmojnë sot prania e pikturave, edhe pse të dëmtuara, në Kishat: Pllanë, Balldre, Rubik e Derven.

Ndërtimi i kishave, abacive dhe kuvendeve në mesjetë, në tokën Arbërore kushtuar Zojës së Bekuar dhe stolisja me ikona të Zojës së Bekuar, ishte shenjë e nderimit të madh të popullit tonë ndaj kësaj Nënë Hyjnore. Kjo shihet nga edhe fakti se një ndër 7 pikturat e realizuara nga bashkëkohësi i saj, Shën Luka ungjilltar, kushtuar Zojës së Bekuar, ka qëndruar në katedralen e Ulqinit deri para shkatërrimeve osmane në vitin 1571, dëshmohet në *Iliricum Sacrum* të Farlati - Riceputi. Në këtë vazhde të vlerësimit të posaçëm ndaj Nënës së Krishtit, është edhe Kisha *Zoja e Këshillit të Mirë*, bri Kalasë së Shkodrës, e shek. XIII, e shndërruar në një Shenjtërore mbarëkombëtare, për shkak të mrekullive të ndodhura nga rrezatimi shpirtëror i ikonës murale, vendosur në altarin qendror të këtij tempulli fetar. Duke ruajtur një mister rreth vetes, që tejkalon fazën e Krishterimit, Shenjtërorja e Zojës së Këshillit të Mirë, bëri që heroi ynë legjendar, Gjergj Kastrioti dhe Donika, të çonin dhurata të çmuara prej ari e argjendi e ta donin këtë Shenjtërore mrekullibërëse, me një dashuri të

përkushtuar e entuziast. E Nëna e Kujdesit të Mirë, siç e quanin disa, si shpërblim, jo vetëm që e bëri atë një shëmbëlltyrë të përsosmërisë kishtare, po i dha edhe pushtet të pamposhtur, jo vetëm që shpëtoi Shqipërinë nga pushtime e egra turke, por edhe krishterimin, gjatë mbretërimit të tij.

Koha e errësirës kulturore – Perandoria osmane dhe shkatërrimet

Duke u pushtuar nga Perandoria Osmane, në vitin 1434, nga sulltani Murati II, Shqipëria kishte filluar të mbante mbi kurrizin e vet një kalvar tejet të mundimshëm pesëshkullor.

Ngjarjet që kanë lidhje me zhvendosjen e afreskut të Zojës së Këshillit të Mirë për në Gjenecano, ishte fushata e egër e ndërmarrë në Arbërinë e Mesme dhe Veriore nga sulltan Mehmeti II në vitin 1466-1467. Duke dëgjuar për sëmundjen e Gjergj Kastriotit, në fillim të vitit 1467, sulltan Murati do të shprehej: Kush do të më ndalojë t'i shfaros të krishterët? Kanë humbur shpatën dhe mburojën e tyre. (v. Dandolo, Roma dhe Papët, vol.2). Kërcënimet e sulltanit pasuan ngjarjet e pranverës të vitit 1467, si: rrethimi i dytë i Krujës, Lezhës, Drishtit, Shkodrës dhe pushtimi i Danjës. Me këto djegie, tortura e vrasje të shqiptarëve nga Mehmeti II, populli ynë ishte trulllosur dhe u mendua së mbërriti dita e gjykimit të Hyjit, ku e gjithë Shqipëria do të përfshihej në shfarosje.

Hakmarrja turke i bëri ata që të parashikonin jo vetëm humbjen e menjëhershme të pasurive, por edhe shtypjen, ndikimin brutal, shfarosjen e plotë të besimit dhe të qytetërimit. Duke mos parë asnjë rreze shprese nga këta njerëz, populli iu drejtua qiellit: mbushte tempujt e shenjtë, shumëfishonte lutjet publike, mbante kreshmë të rreptë dhe i lartësonte Hyjit premtime të çdo lloji, që ta ndalte fatkeqësinë e zemërimit të tij.

Zhvendosja e Figurës së Zojës nga Shkodra për në afërsi të Romës, në Gjenacano në vitin 1467

Vërehej bri kalasë së qytetit të Shkodrës, mbi një kodër, një kishë e vogël ku nderohej një figurë çudibërëse e Marisë tejet të shenjtë, e pikturuar në mur, që mbante emrin *Zoja e Këshillit të Mirë*.

Para saj ishte lutur shumë herë trimi Kastriot dhe kishte marrë atë shkëndijë trimërie dhe zjarri, falë të cilit, në mes të betejës dhe flakëve, ngjante si Hyji i luftës; dhe tani shkodranët i drejtoheshin po Asaj për t'ju lutur që të largonte fatkeqësinë e shkaktuar nga perandoria osmane. Në afrimin e paepur të fatkeqësisë turke, shumë prej tyre nuk



dinin ku tjetër të gjenin shpëtim veçse jashtë atdheut dhe të kërkonin në vende të huaja sigurinë e një jete të vështirë prej mërgimtari. Para se të merrnin rrugën e mërgimit, shkodranët shkonin të pikëlluar që t'i kërkonin ndihmë Zojës së tyre, që me keqardhje duhej ta linin vendlindjen në duart e njerëzve të egjër dhe brutalë, dhe i luteshin për të fundit herë që t'i shoqëronte me bekimin e saj në të panjohurat e mërgimit. Mes këtyre mërgimtarëve dalloheshin për mëshirën e tyre dy vëllezër katolikë, të pikëlluar thellë për fatet e ardhshme të atdheut të tyre. Njëri prej tyre ishte familja De Sklavis, dhe shqiptari tjetër, me mbiemër Gjergji. Nëse i referohemi aspektit teologjik, afresku i Zojës në mënyrë të mrekullueshme ishte shkëputur nga muri, duke u paraprirë dy rojeve, Gjergjit dhe Sklavis, kishte kaluar detin e Adriatikut dhe kishte zënë vend afër Romës në Gjenacano, më 25 prill, 1467. Por, nëse i referohemi anës studimore, atëherë themi se, për shkak të shkatërrimeve turke, për ta shpëtuar këtë vepër unike, ajo që shkëputur nga muri i kishës dhe në mënyrë të mirëkoordinuar që mbartur për në Gjenacano, ku shërbenin eterit eremitë agustinianë, dhe fisnikja, Petrucia, e cila kishte filluar ngritjen e një kapeleje të veçantë për figurën e Zojës. Hired mrekullibërëse që filloi të shpërndante Virgjëresha nga shtëpia e saj e re në Gjenecano, ishin të shumta dhe kaq të

jashtëzakonshme, sa që u desh të merrej Selia e Shenjte që të shqyrtonte, të vërtetonte dhe t'i regjistronte zyrtarisht ato.

Zëri i një shfaqjeje të mrekullueshme të Virgjëreshës në Gjenacano vjen deri në Romë, dhe papa Pali II, në vitin 1467, ngriti një komision, i cili në bazë të studimeve të kryera, shprehet se, Figura e Zojës është mrekullibërëse. Këtë figurë, si të tillë, e kanë konsideruar edhe papë të tjerë në vazhdim: Siksto IV, 1475; Urbani VIII, 1630; Benedikti XIV, 1753; Pio IX, 1854; Leoni XIII 1883; Gjoni XXII 1959; e deri tek papa Gjon Pali i II, më 25 prill 1993, me rastin e ardhje së tij në Shqipëri.

Papët e pranojnë se afresku i “Zojës së Këshillit të Mirë” është nga Shkodra

Për lidhjet e kësaj figureje me Shkodrën flet papa Benedikti XIV në bulën e tij në vitin 1753, ku ndër të tjera është shprehur, se: *Figura siç thotë gojëdhëna e devotshme, me shërbesë të engjëjve, ishte bart prej qytetit të Shkodrës e çua në Gjenecano*. Po kështu flasin shumë nga eprorët e lartë të etërve Agustinianë. Dëshmime të shqiptarëve në këtë drejtim janë të shumta nga ata të shpërngulur në Lacio, Kalabri e Pulia, si dhe dëshmitë e shkodranëve të shpërngulur më vonë nga represaliet turke. Nga dëshmitë e arbëreshëve do të veçonim Dom Shtjefen Rrodotaji në vitin 1713 dhe kanonikun Baçi në vitin 1747. Ndër autoritete e larta nga Shqipëria, kemi dëshmitë që kërkoreshin nga Selia e Shenjtë: Konti Shtjefen Medini, 1742, dëshmia e fisnikut Kol Kamsit, e arqipeshkvit të Shkupit Gjon Nikollë Kazazit, të dyja në vitin 1745.

Duke iu rikthyer historikut të kësaj figure, me në krye Atë Belgranos, etërit agustinianë, formuan më 8 korrik të vitit 1878, komisionin e posaçëm që do merrej me këtë punë. Në komision bënë pjesë Atë Gianpiero Da Bergamo, Don Engjëll Radoja e Don Pashko Junku. Në përfundim, ky komision, me kryepeshkvin Karlo Poten, dhanë analizën e hollësishme për vendin e gërmadhave bri kalasë Rozafat nga ishte zhvendosur për në Gjenacano, Itali, figura e Zojës së Këshillit të Mirë, në vitin 1467. Kjo analizë përputhej me të dhënat e publikuara më parë nga shqiptarët në mërgim dhe krerët e lartë kishtarë nga Shqipëria.

Historia më e thelluar rreth Shenjtërores së Gjenacanos, figurës së mrekullueshme dhe lidhjeve të ngushta që ky afresk ka me Shkodrën dhe popullin shqiptar, është pasqyruar më së miri në librin e ipeshkvit të Sidnev, (Australi) misionarit apostolik, Mons. Giorgio Dillon, *La Virgine Madre*

di Buon Consiglio, Siena, 1892.

Përshpirtëria ndaj Zojës së Bekuar nuk ishte ndërprerë as në kohën e pushtimit osman, në kohën kur perandoria osmane në shek. XIX, ishte në shkatërrim e sipër, por sa kishte ardhur duke u shtuar. Nisur nga ky fakt dhe të tjera fakte historike, në emër të ipeshkvijve të trevave shqiptare, kryepeshkvi i Shkodrës, Pashko Guerrini, në vitin 1872, i ftoi besimtarët që të jepnin kontributin tyre për ringritjen e gërmadhave ekzistuese të një Shenjtëroreje dinjitoze për popullin shqiptar.

Për t'i dhënë një hov të ri shpirtëror dhe kombëtar, ipeshkvijtë e dioqezave shqiptare në Koncilin e tretë të Arbrit në vitin 1895, kërkuan nga Selia e Shenjtë që *Zoja e Këshillit të Mirë*, të shpallet zyrtarisht, *Mbrojtësja e Popullit Shqiptar*. Kjo kërkesë u pranua nga papati dhe në vitin 1896 papa Leoni XIII dha përgjigjen pozitive, duke ia mbështetur popullin shqiptar Nënës Qiellore. Ky vendim i Selisë së Shenjtë, që një nxitje e mëtejshme për grumbullimin e mjeteve financiare për ringritjen e Shenjtërores së re. Por për shkak të luftimeve ballkanike, themelet e saj u vendosën më 17 gusht të vitit 1917, në kohën e Austro-Hungarisë. Në shenjë përkrahjeje të shenjtërores u themelua edhe revista, *“Zoja e Shkoders, Drita e Shqypniës”*. Rrethanat politike e shoqërore ngadalësuan punimet, të cilat përfunduan me inaugurimin e bërë ditën e festës së *Zojës së Këshillit të Mirë*, më 26 prill të vitit 1930. Kjo shenjtërore gjigante u shkatërrua gjatë sistemit komunist me rastin e mbylljes së kishave në krejt Shqipërinë, në vitin 1967. Pas demokratizimit të vendit, në vitin 1994, rifilluan punimet në ndërtimin e kësaj Shenjtëroreje legjendare, e cila u inaugurua më 26 prill të vitit 1989.

Afresku, i cili sot gjendet në Gjenacano, sipas grupit të studiuesve shqiptar dhe italian, i cili bëri analizat fizike bërthamore, të këtij afresku më 19-21 mars 2017, rezulton se është një imazh mural unikal dhe ka një madhësi prej 85 gjatë me 43 e gjerë cm., në krahasim me atë që jemi mësuar ta shohim deri tani, 42.5 gjatë me 31 gjerë cm.. Kjo figurë e shekullit XIII, apo fillim shek. XIV e cila paraqet Zojën e Bekuar ulur me fëmijën në krah, tani fiton një vlerë edhe më të madhe kombëtare, për shkak të zbulimeve më të reja, vlerës artistike dhe historikut që ka në lidhje me zhvillimin e kulturës shqiptare në mesjetë.

(Konferencë shkencor Ndërkombëtare, “Zoja e Shkoders Drita e Shqypniës”, kushtuar Zojës së Këshillit të Mirë, më rastin e 550 vjetorit të shpërnguljes në vitin 1467, për në Genazzano, organizuar në Shkodër më 22. Prill 2017).

ZOJA E SHKODRËS RIKTHEHET NË KATEDRALE PAS RESTAURIMIT NË FIRENCE

Kryevepra e shekullit XIX, që i mbijetoi përndjekjes së regjimit komunist, u rishfaq e rilindur në Katedralen e Shkodrës. Më 25 prill 2017, ceremonia e prezantimit të veprës së restauruar, në prani edhe të ministres së Kulturës, Kumbo, dhe atij të Punëve të Jashtme, Bushati.

Shkodër, 25 prill 2017 – 550 vjet nga dita kur ikona e parë e Pajtores së Shqipërisë, Zojës së Shkodrës, u përcoll nga Shkodra drejt Genazzano-s në Itali, kjo kryevepër e 1800-tës u rishfaq sot e rilindur në Katedralen e Shkodrës, falë bashkëpunimit të Ministrisë së Kulturës me laboratorët e ekselencës së institutit Palazzo Spinelli në Firence.

“Zoja e Shkodrës”, një kryevepër që i mbijetoi përndjekjes së regjimit komunist dhe kohës, u restaurua në Firence dhe u rikthye në Shkodër.

Duke marrë fjalën në ceremoninë që u zhvillua paraditen e së martës në Seminarin Ndërdioqezan Shqiptar “Zoja e Këshillit të Mirë” Shkodër, ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro kujtoi momentin kur pa për herë të parë ikonën e “Zojës së Shkodrës”, në shtator 2015 në famullinë e Shën Shtjefnit, dhe vendimin e menjëhershëm për restaurimin e saj, si simbol jo vetëm i Shkodrës, por si pajtore e Shqipërisë.

“Gjithçka nisi në shtator 2015, kur ndeshëm në telajon e ikonës që na magjepsi me vështirimin ende të pashuar dhe përkuljen elegante, por edhe më tronditi jo pak pasi rrjepja e kohës dhe dhuna qoftë edhe metaforike që duhet ta kishte përplasur atë ikonë në vitet e errëta kur artin religjioz e burgosën pa e shuar, të gjitha këto flisnin më shumë se vetë ikona. Madona është një imazh tradicional i shenjtë dhe i interpretuar në të gjitha llojet e arteve pamore. Veprat e frymëzuara nga ky subjekt kanë Jezusin fëmijë në krahë, por ndryshe ishte ikona që pashë, dhe aty dëgjova historinë e Zojës së Shkodrës. Nuk i rezistova tundimit për ta prekur me dorë dhe aty për aty mora vendimin se Zoja e Shkodrës meritonte edhe identitet artistik, përtej atij shpirtëror që mbart”, tha Kumbaro.

Sipas Kumbaros, “nga ky moment filloi edhe ky udhëtim i dytë i Zojës, në fillim drejt Tiranës për ta restauruar edhe pse mundësitë tona për të restauruar telajo janë thuajse zero, prandaj marrëveshja me Firencën ishte një mundësi e shkëlqyer që vetëm do të përforcohej”.

“Ne e kemi ndjekur ikonën në proces e sipër

restaurimi dhe jemi mahnitur nga kujdesi apo cilësia e punimeve. Nga pikëpamja profesionale dhe bashkëpunimi ndërkulturore falënderoj të gjithë ekspertët e Firences, por mbi të gjitha Dom Arturin dhe Famullinë e Shën Shtjefnit, që na dorëzoi Zojën, duke na bërë të ndërgjegjshëm që nuk kishim marrë në dorëzim thjesht një pikturë, por kishim marrë në dorë gjithë Shkodrën, kryeqytetin e kulturës”, tha Kumbaro.

Ministri i Punëve të Jashtme Ditmir Bushati u shpreh se “ky përvjetor i 550-të i shpërnguljes së Zojës është paradoksisht një moment për të kremtuar rikthimin e saj. “Një histori mistike, një



parabol e përkryer e historisë të popullit tonë dhe sot mund të gëzohemi për restaurimin e kësaj pikturë të Zojës. Dom Arturit i pëlqen të thotë se Zoja e Këshillit të Mirë është Kryezojë, Zoja e shpërngulur ishte natyrshëm Zoja e të arratisurve, e diasporës dhe e kurbetit”, tha Bushati.

Duke u ndalur te procesi i restaurimit, ai theksoi se restaurimi nuk mund të kuptohet pa procesin e dëmtimit. “Nuk mund të ketë rikthim në identitet pa pajtim me veten,

sikundër nuk mund të ketë restaurim pa kuptuar dëmtimin. Vepra që na kishte mbetur ishte dëmtuar jo vetëm nga koha dhe kushtet e këqia, por edhe presioni i arratisë censuruese. Sot në këtë sallë nuk jemi të gjithë të njëjtë besim, por duhet të ndiejmë të gjithë atë që sjell puna e përbashkët duke restauruar. Vendi ynë ka po ashtu nevojë për memorien kolektive të shtetndërtimit, shoqëria jonë ende po përjeton dëmtimin. Vetëm duke rigjetur momentet e shpresës dhe duke restauruar brenda vetes copëzat, vetëm në këtë mënyrë do të dalim nga marrëzia e dëmtimit dhe urrejtjes”, tha Bushati.

Shkodër, 25 prill 2017.

TË EDUKOHESH ME TË BUKURËN


*Një studim mbi komisionimin e veprave të artit për kultin
Luigi Territo S. I.*

Të rindërtosh dialogun mes artit dhe besimit është një rrugëtim që kërkon një takim mes artistëve, komisionit kishtar dhe kulturës bashkëkohore. Një njohje e cila shkon përtej ideve tradicionale ideologjike për të eksploruar itinerare të reja në gjuhën e thellë të historisë së artit. « duhet të ndjekim atë lëvizje qendrore që na çon tek arti i madh dhe i shumëllojshëm i eksperiencës artistike bashkëkohore » - kjo në një mënyrë të sintetizuar. Është ky mendimi i shprehur nga kardinali Gianfranco Ravasi në rastin e prezantimit të projektit « Të edukohesh tek e bukura. Studim mbi formimin e klerit dhe artistëve që përfshihen në komisionin e veprave të artit për kultin e krishterë. »

Në konferencën e prezantimit, e zhvilluar në 19 janarin e vitit të kaluar, në karrigen e Këshillit Papnor të Kulturës, kanë ndërhyrë kardinal Ravasi, Monsinjon Nunzio Galantino, sekretari gjeneral i Konferencës Peshkopate italiane (CEI), peshkopi Carlos Alberto de Pinho Morerira Azevedo, i deleguari i ministrisë, Mosnini Pasquale Iacobone dhe Don Valerio Pennasso, përgjegjës të Artit dhe Besimit, si dhe të Zyrës Nacionale për ndërtesën e kultit të CEI.

Departamenti Art dhe Besim në bashkëpunim me Zyrën Nacionale për të Mirat e Përbashkëta të kulturës kishtarë, ka zhvilluar së fundmi një kërkim, për të ndërtuar një « hartë » mbi ofertën formuese që i drejtohet atij që punon në fushën e komisionit kishtar dhe krijimit artistik në shërbim të vendeve të kultit. Projekti do që të dallosh « nivelin e formacionit estetik dhe historik-artistik të klerit shekullor dhe besimtar, të operatorëve pastoral dhe kulturor të dioqezës (...) dhe të artistëve të thirrur për të vepruar në fushën e kishës (arkitektë, piktorë, skulptorë, muzikantë, fotografë, etj.) »

Studimi, sipas udhëzimeve të Ministrisë do të zhvillohet fillimisht në territorin italian, për të kaluar në një përfshirje me konferenca të tjera peshkopësh.



Arti i shenjtë bashkëkohor, gramatika dhe ndjeshmëria

Në relacionin e tij, kardinali Ravasi ka marrë në konsideratë dy tema të rëndësishme, të cilat shënojnë hapin e parë të kësaj iniciative : mbrojtja dhe realizimi i trashëgimisë artistike të ruajtur në kishë , është një kuptim gramatikor i gjuhës artistike bashkëkohore në raport me tradicionalen. Sipas Ravasi, arti i shenjtë ka një gramatikë të re në krahasim me të kaluarën. Fotografia, video-arti dhe forma të tjera të kërkimit artistik dhe muzikor kanë hyrë me kohë në gjuhën e përbashkët kishtarë. Mes bashkëpunimeve të arrira, si kisha e Atit të mëshirshëm e Tor Tre Teste, Rikard Mayer, famullia Merate e projektuar nga Botta, hasen fatkeqësisht edhe shembuj të këqij që i mungon ndjeshmëria artistike dhe arkitektonike, ku ati Turoldo nuk do të kishte hezituar të thoshte: «

garazhi i shenjtë ku besimtarët janë të parkuar përpara Zotit».

Jo të pakta janë dyshimet e përfshira në vëzhgimet finale. Ka mbase një rezistencë nga ana e komisionit të artit të shenjtë në krahasim me format dhe gjuhët e artit bashkëkohor. Gjatë konferencës janë hasur tre vështirësi :

E para, është e aspektit financiar : të besosh tek veprat dhe artistët e rëndësishëm kërkon një investim ekonomik të konsiderueshëm.

E dyta është mungesa e një formimi të përshtatshëm historiko-artistik nga ana e klerit dhe e punonjësve pastoral, që të aftësohen për të bashkëvepruar më mirë me gjuhën e kohës sonë.

E treta lidhet me bashkimin e ndjeshmërisë estetike dhe shpirtërore, mes komunitetit tonë të krishterë dhe të eksperimentimeve artistike e muzikore të artistëve bashkëkohor.

Arti i vërtetë ushqehet sigurisht me liri dhe risi, por një art i destinuar vendeve të kultit nuk mund të mos lëshojë rrënjë në dialogun e frytshëm mes traditës, liturgjisë dhe eksperiencës së fesë të bashkësisë lokale. Artistët shpesh mëkatojnë për vetëreferim : të zënë me « *kërkime të fshehta* », nuk i kushtojnë rëndësi ndjeshmërisë së popullit të krishterë dhe përdorimit të hapësirave liturgjike. Prandaj, projekti Edukimi i të Bukurës i drejtohet edhe atyre.

Të edukosh do të thotë të edukohesh reciprokisht, në një ndërrim zërash, në të cilin dëgjimi dhe bashkëpunimi janë elementët e duhura dhe thelbësore. Nuk ka të bëjë me bashkëpunimin e disa linjave të afta për t'i dhënë kreativitet arkitektëve, artistëve dhe muzikantëve, por të bëjë një përfshirje dialoguese mes artit, teologjisë dhe botës bashkëkohore ; një lidhje kjo që mund të bëjë lindjen e ndjenjave të paeksploruara, në atë linjë që ndan dhe bashkon të dukshmen me të padukshmen, fundin me pafundësinë.

Të gjitha këtyre që i kushtuam vëmendje më lart, nuk duhet që të ndalojnë të menduarit origjinal dhe novator. Siç kishte vënë re kardinal Ravasi, risitë e mëdha në kampin artistik dhe muzikor lindin nga guximi i burrave dhe i grave të cilët kanë arritur të transformojnë gjuhën artistike të kohës në forma që deri atëherë ishin të panjohura. Mjaft të mendosh më për zhvillimin polifonik të Palestrinës në krahasim me monotoninë gregoriane, të intuitës së kardinalit Francesco Maria del Monte, i cili i lejoi Caravaggios të bëhej ai mësues i padiskutueshëm që sot të gjithë njohim.

Gjatë konferencës është kujtuar nxitja apolostike « *Evangelii gaudium* » (Gëzimi i

Ungjillit) EG, në të cilën papa Francesco e përfshin kishën në një formim drejt rrugës të së bukurës (*via pulchritudinis*), (Rruga e së bukurës) duke vendosur raportin mes veprës evangjelike të kishave të veçanta dhe nga ana tjetër përdorimin e artit bashkëkohor. Nxitja shpreson « pasurimin e vazhdueshëm të së kaluarës », gjithashtu edhe një vështirësi të shumë ndjenjave aktuale dhe në fund të transmetojnë besimin në një « gjuhë të re alegorike » . (EG 167).

Bukuria si një instrument i transformimeve sociale.


Bukuria në shërbim të fesë është edhe një funksion social dhe edukativ, siç ka thënë monsinjor Galantino. Bukuria mund të marrë në pyetje kohën tonë, duke pasur qëllimin që « *shoqëritë tona të jenë mikpritëse dhe të kenë dialog (...)* ». Një komunikim i edukuar me dialog bëhet urë për një bukuri që edukon . Atëherë, bashkimi mes etikës dhe estetikës krijon vende dhe bashkësi që mund t'i konsiderojmë « *oaze paqeje dhe bukurie* ». Kemi nevojë për ndërtesa të shenjta që edukojnë me harmoni dhe bukuri, pasi « *ambientet e shëmtuara krijojnë burra jo të mençur* ».

Prezantimi i projektit ishte edhe një rast për të theksuar raportin e ngushtë, mes edukimit estetik dhe kujdesit ndaj ambientit, siç vuri në dukje papa Francesco Në këtë kontekst, -shkruan Papa « *Laudato sii* » (LS), - *nuk tërhiqet zvarrë (...) lidhja që krijohet mes një edukimi të përshtatshëm estetik dhe mirëmbajtjes së një ambienti të shëndetshëm »* (LS 215). Ambienti njerëzor, i makinave dhe ai natyror i bën njerëzit që të jetojnë të kushtëzuar në të mirë dhe në të keq jetën e tyre. Bukuria e të krijuarit na flet për kujdesin që Zoti ka për njerëzimin dhe krijon një peizazh të shkëputur nga interesat ekonomike, i cili i turbulluar nga abuzimet mbetet një horizont i heshtur dhe i pakalueshëm. Edhe bukuria mund të bëhet instrument i transformimit social.

Për Papa Francesco, bukuria mund të sjell « *shkëndija lumturie dhe besimi dhe në kontekstet më të vështira dhe të rëndomta* ».

Në mesazhin drejtuar Akademisë Pontificie për temën « *Shkëndija bukurie për një pamje njerëzore të qytetit* », e zhvilluar në Vatikan në dhjetor 2016, Papa shkruan : « *duke shikuar kështu detyrën e rëndësishme dhe të nevojshme të artistëve, veçanërisht atyre që janë besimtar dhe e lënë veten të lirë që të ndriçohen nga fryma e Ungjillit të Jezu Krishtit : duhet të krijojnë vepra arti që sjellin , një shenjë, një shkëndijë shprese dhe*

besimi, aty ku njerëzit e ndiejnë veten të dorëzuar ndaj indiferencës dhe keqdashjes, pikërisht duke përdorur gjuhën e së bukurës. Arkitektë dhe piktorë, skulptorë dhe muzikantë, fotografë dhe poetë apo artistë të çdo lloji disipline, janë thirrur që të ndriçojnë të bukurën, e mbi të



gjitha aty ku errësira apo ngjyra gri zotërojnë përditshmërinë (...) I ftoj, andaj, që të kujdesen për bukurinë, dhe bukuria do t'i shërojë shumë plagë që lënë gjurmë në zemër dhe shpirtin e burrave dhe grave të ditëve të sotme.”

Në fjalët e Papës duket se ushton mendimi i një prej teologëve më të mëdhenj të shekullit XX, Hans Urs Balthasar. Pasojat e rrezikshme të ardhura nga copëzimi i lidhjeve mes të bukurës dhe të vërtetës kanë vënë në diskutim kuptimin e të mirës dhe « evidentimin e detyrës së saj që duhet të jetë e mirë realizuar ». « Në një botë pa bukuri (...) edhe mirësia e ka humbur forcën e saj të tërheqjes ». Teologu zviceran konstaton se « bukuria e pa interesuar (...) i ka thënë lamtumirën botës moderne të interesave, për ta braktisur dhe duke e lënë kështu në lakminë dhe trishtimin e saj.

Bukuria a është e vërtetë ?

Akoma sot artistë dhe konsumatorë janë thirrur që të ecin në këto rrugë, në të cilat bukuria flet gjuhën e mirësisë dhe së vërtetës. Likuidimi i bukurisë, që në shekullin XX është interpretuar shpesh si një shprehje false dhe e gënjeshtërt, ka prodhuar atë fenomen që filozofi Remo Bodei e ka quajtur « apoteoza e së shëmtuarës ». Me këtë ndjesi duhet të prezantojmë një estetikë praktike që quan autentikë dhe të vërtetë vetëm atë që prezanton keqësi dhe pabukuri. Luftëra, masakra dhe dhimbje nuk janë realitete të lidhura vetëm me kohën tonë. Sigurisht që është e vërtetë që kur një kulturë injoron të Përsosurin duhet detyrimisht të drejtojë shikimin e tij drejt horizontit të limituar të brishtësisë njerëzore dhe është pikërisht këtu dialogu mes artit dhe besimit ku mund të gjejmë pikën e rinisjes.

Idetë dhe realizimet e një artisti janë rreptësisht të lidhura me atë vizion dhe eksperiencë të botës në të cilën ai jeton dhe punon. Duke filluar nga instrumente dhe teknika të trashëguara nga historia, ai krijon dhe dialogun me brendësinë e horizontit kulturor në të cilin është i përfshirë. Sfida e madhe do të jetë ajo e të thënë « Zot! » në një botë dhe kulturë që ka humbur besimin në Zor. Nuk është arti që nuk mundet më të shprehë thellësinë metafizike të bukurisë dhe vlerën e saj të vërtetë, por është bota në të cilën jetojmë që e ka mohuar këtë gjë. Megjithatë, arti ekziston akoma dhe kujdeset për njeriun edhe për kërkimin e kuptimit të jetës së tij. Nga këtu është e nevojshme të rifillojmë.

Historia dhe dialogu i frytshëm mes artit dhe teologjisë na kanë paraqitur rrugë të ndryshme, por edhe plotësuese. Drita e artit bizantin dhe meditimi i dhimbshëm « *sub contraria specie* » i Kryqëzatës mesjetare të pikturës na ofrojnë ne sot, shenja të reja dhe simbole që të dimë për të mishëruar në kohë misteret e mëdha të besimit të krishterë.

Gjithnjë arti dëshiron të depërtojë sipërfaqen e ekzistencës, nuk kënaqet vetëm me të dukshmen. Ai kërkon që të këtë një hapësirë ku të mund të krijohet një urë mes eksperimenteve të përpunuara artistike të ditëve të sotme dhe artit të destinuar vendeve të kultit. Marc Chagall thoshte që « *piktorët për shekuj me radhë kanë zhytur penelat e tyre në këtë alfabet të ngjyrosur që është Bibla* », sot shpesh artistët zhysin penelat e tyre në udhëkryqin e ekzistencës njerëzore, ku dëshpërimi dhe shpresa takohen dhe luftojnë mes tyre. Është pikërisht aty ku duhet të shohim.

**Përktheu dhe redaktoi:
Bernardina Shahini**

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, " Zoja e Shkoders Drita e Shqypniis"


550 vjetori i zhvendosje së figurës murale "Zoja e Keshillit të Mirë", nga Kisha bri kalas Rozafat, në vitin 1467, për në Gjenecano, Itali. Me 22 prill 2017, në Seminarin Nderdioqezan, " Zoja e Këshillit të Mirë, në Shkodër, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare, organizuar nga Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë. Në fillim konference e hapi Rektori i Shenjtërore, Dom Artur Jaku dhe fjalën e



përshëndetëse e mbajti kryetari i konferencës Mons. Angelo Massafra. Referuesit gjithsejtë trembëdhjetë në numër të ardhur nga Italia, si dhe ata vendas, hodhen dritë mbi të kaluarën e kësaj ngjarje të rëndësishme për popullin tonë, e cila asnjë herë nuk ishte ndriçuar deri tani në fund. Kumtuesit nga Italia: Lucia Nadin, Italo Sarro, Andrea Di Gueseppe, Rocco Ronzani, Luis Manuel Cunaramos, sollën shënime të reja dhe shumë interesante për traditën 550 vjeçare të nderimit të popullit italiane e shumë popuj të Evropës që kanë shfaqur ndaj figurës së "Zojës së Këshillit të Mirë", e cila që nga 25 prilli 1467 gjendet në Shenjtëroren agustiniane në Gjenecano afër Romë. Pati dhe mendime që figura në fjalë është prodhim i kulturës italiane, por shumica e studiuesve shpalosen argumente së kjo ikonë murale është prodhim i kulturës shqiptare e shek.. XIII apo fillim të shek.. XIV.

Zbulimet e muajt mars 19-22 të këtij viti, ku një grup studiuesish nga Shqipëria në bashkëpunim me ekspertet italian, zbardhen rezultatet shkencore, ato qenë befasuese. Analizat fizike bërthamorë tregojnë së figura në fjalë nuk është e rrethit të Lacio apo vendeve përreth, por ka gjasa të jetë e prodhime në kulturës sonë veriore kombëtare. Kurse, Dom Nikë Ukgjini në referatin e tij, solli fakte historike që përputheshin me idenë e grupit të ekspertëve, duke argumentuar së kjo figurë është shkëputur nga Kisha kalë e Shkodrës dhe është sistemuar në Gjenezano për të shpëtuar nga shkatërrimet osmane.





Ndoc Ndoja

DUSHMAN - TEMALI


Camaj - Pipa, Shkodër 2008



Marin Barleti

RRETHIMI I SHKODRËS

Pakti,
Tiranë 2011



At Justin Rrota OFM

RRETHIMI I QYTETIT

Botime Françeskane
Shkodër, 2010

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 3/4 (493-494) Mars - Prill 2017